FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.120 31 korrik 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1023, datë 9.7.2008	Për miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat shtetërore në vitin 2007" ……	5277
Vendim i KM nr.1037, datë 2.7.2008	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009 …….	5300
Kërkesë e METE nr.4766/5, datë 3.7.2008	Për shpronësim publik, me interes publik, të pasurisë së paluajtshme, të tipit "tokë truall" që preket nga "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kv Tirana-Qendër"…….	5310

VENDIM
Nr.1023, datë 9.7.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR "PËR NDIHMAT SHTETËRORE NË VITIN 2007"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 shkronja "dh", 18, shkronja "e", dhe 32, pika 2, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat shtetërore në vitin 2007", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORTI VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2007

TABELA E SHKURTIMEVE

CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së lirë të Evropës Qendrore
PE	Parteneriteti Europian KE Komuniteti Europian BE Bashkimi Europian
GATS	Marrëveshja e Përgjithshme për Shërbimet Tregtare
GATT	Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë
PPB	Prodhimi i brendshëm bruto
MP	Marrëveshja e Përkohëshme
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
NUTS	Nomenklatura e Njësive Statitistikore Territoriale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
KNSH	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
DNSH	Drejtoria e Ndihmës Shtetërore
SCMA	Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese
SME	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

KAPITULLI 1

1. HYRJE

Detyrimet ndërkombëtare për ndihmën shtetërore në Shqipëri, përfshirë kërkesat për transparencë dhe raportimin ndërkombëtar, burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian dhe shtetet anëtare, nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) 2006, si dhe nga Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese (SCMA) në kuadër të OBT-së. Në mars 2008 vendi ynë raportoi në OBT për subvencionet e dhëna gjatë vitit 2007.

Legjislacioni i ndihmës shtetërore (ligji dhe rregulloret në zbatim të tij) hyri në fuqi në janar 2006[1], periudhë prej së cilës vepron dhe sistemi kombëtar i ndihmës shtetërore për mbikqyrjen, kontrollin dhe monitorimin. Duke iu referuar dhe raporteve të progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë, të viteve 2006[2] dhe 2007[3], në fushën e ndihmës shtetërore, brenda një kohe të shkurtër, është arritur një progres thelbësor. Këto raporte vlerësojnë se përveç legjislacionit janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore, përkatësisht Drejtoria e Ndihmës Shtetërore

[1] Ligji nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore".
[2] Komisioni i Komunitetit Europian, Progres Raporti 2006 për Shqipërinë, COM (2006) 649.
[3] Komisioni i Komunitetit Europian, Progres Raporti 2007 për Shqipërinë, COM(2007)663

(DNSH) dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH). Komisioni Europian ka vlerësuar, gjithashtu, se këto struktura kanë rritur shkallën e ekspertizës në drejtim të vlerësimit të skemave ekzistuese dhe shqyrtimit të skemave të reja të ndihmës shtetërore.

Në dhjetor 2007, KNSH ka përfunduar shqyrtimin dhe vlerësimin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore, duke propozuar, kur ka qenë e nevojshme, marrjen e masave për përshtatjen e tyre me rregullat e BE-së në këtë fushë. Raporti "Për inventarin e skemave ekzistuese në Shqipëri" është miratuar me VKM në janar 2008[4] dhe i është përcjellë Komisionit Europian në prill 2008. Ky raport është një hap i rëndësishëm i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të detyrimeve të saj ndërkombëtare për vendosjen e rregullave të ndihmës shtetërore, monitorimin e tyre dhe sigurimin e transparencës.

Në bazë të nenit 17 (f) të ligjit "Për ndihmën shtetërore", KNSH ka detyrimin të hartojë, me ndihmën e Drejtorisë, raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe ta paraqesë atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili e përcjell në Komisionin Europian. Raporti për ndihmat shtetërore në RSH për vitin 2007 është përgatitur në përputhje me këto dizpozita ligjore dhe kërkesat e MSA-së dhe CEFTA-s.

Raporti i parë i ndihmave shtetërore jep një përshkrim të objektivave kryesorë që duhen arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumenteve të përdorura në periudhën 2005-2007. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 20052007 është vlerësuar në rreth 21.4 miliardë lekë (176 millionë €), prej të cilave 11.4 miliardë lekë (94 millionë €), që përfaqësojnë 1,2% të PPB-së, janë dhënë në vitin 2007. Duhet të theksohet se pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin "de minimis" të BE-së dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Ky raport shërben si një mundësi për të nxitur transparencën në marrëdhëniet ndërkombëtare të tregtisë, për sa i përket ndihmave shtetërore dhe subvencioneve. Nga ana tjetër, paraqitja e të dhënave të ndihmës shtetërore duhet parë në një kontekst dinamik, duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Theksi vihet në zhvillimet e reja të politikës industriale, që ka të ngjarë të ndryshojnë modelet e shpërndarjes së skemave të ndihmës në të ardhmen. Kjo lidhet në veçanti me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2008-2013)[5], e cila ndër të tjera, u tregon apo u sugjeron autoriteteve shqiptare të përgatisin skema të projektuara dhe orientuara në bazë të zhvillimit shumë vjeçar dhe që të synojnë drejt zhvillimeve strategjike të ekonomisë, duke vendosur prioritete të pranuara nga të gjithë.

KAPITULLI 2

2. KONTEKSTI EKONOMIK DHE I ZHVILLIMIT

2.1 Situata ekonomike në Shqipëri

Nëse i referohemi standarteve europiane dhe atyre ndërkombëtare, Shqipëria është një vend i pazhvilluar. Megjithatë, gjatë viteve 2004-2007 ajo u karakterizua nga një rritje e përgjithshme makroekonomike, kryesisht e shprehur në një ngritje relative të ekonomisë, mbajtje të inflacionit në nivele të ulta, stabiliteti i monedhës vendase, një performancë e mirë e treguesve e tregtisë së jashtme, si dhe rritje e shkallës së kreditimit të ekonomisë. Vlera mesatare e rritjes ekonomike gjatë periudhës 2004-2006 ishte 5,6%[6], megjithëse kjo u ul në 5% për vitin 2006, si pasojë e problemeve të shfaqura në furnizimin me energji elektrike, që filluan që në fund të vitit 2005. Ekonomia pati një rritje më të ndjeshme, prej rreth 6%, në vitin 2007.

Treguesit kryesorë ekonomikë gjatë periudhës 2000-2007 paraqiten në tabelën 1.

Tabela 1: Treguesit ekonomikë për periudhën 2000-2007[7]

Treguesit	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007*
Rritja reale e PPB (në %)	7,07	6,05	4,07	6	6	5,05	5,5	6

[4] VKM Nr.45, datë 16.1.2008 "Për miratimin e raportit mbi inventarin e skemave ekzistuese në Shqipëri"

[5] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2008-2013), Mars 2008

[6] Burimi: www.mie.gov.al/economic criteria

[7] Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, IMF dhe Banka e Shqipërisë *vlerësim paraprak.

PPB (me cmimet korrente, në milion LEK)	530.900	588.700	624.700	682.700	766.100	836.600	896.300	956.314
PPB (në milion Euro)	4003	4581	4718	4965	5999	6736	7286	7885
Popullsia (në milonë)	3,04	3,08	3,09	3,01	3,02	3,02	3,135	3,162
PPB (për frymë në Euro)	1317	1487	1527	1650	1986	2230	2324	2494
Numri i të punësuarve (në mijë)	1068	1065	921	928	917	932	935	
Përqindja e papunësisë	16,09	14,06	15,08	15	14,06	14,02	13,8	13,18
Norma e inflacionit	4,02	3,05	1,07	3,03	2,02	2	2,4	2,9
Deficiti Buxhetor (në % ndaj PPB)	-8,2	-7,9	-6,6	-4,5	-5,1	-3,6	-3,27	-4
Borxhi publik (në % ndaj PPB)	71,03	66,08	65,03	61,07	56,06	56,07	54,97	53,61
Financim i jashtëm (në % ndaj PPB)	29,04	25,08	23,05	20,06	18	17,05	16,19	15,91
Financim i brendëshëm (në % ndaj PPB)	41,09	41	41,08	41,01	38,06	39,02	38,78	37,7
Llogaria korrente (në % ndaj PPB)	-7	-6,1	-10	-7,9	-4,8	-7,3	-7,4	-11
Kursi mesatar i këmbimit, LEK/EURO	132,06	128,05	132,04	137,05	127,07	124,02	123,01	121,78

2.2. Politikat qeveritare për zhvillimin ekonomik

Prodhimi i përgjithshëm bruto për frymë, në Shqipëri, është afërsisht 18% e mesatares europiane. Parë gjerësisht, kjo e dhënë përcakton jo vetëm boshllëqet e zhvillimit që do të duhet të zgjidhen në vitet e ardhshme, nëpërmjet politikave të Qeverisë, por ajo dëshmon edhe për një prapambetje të vendit në raport me shtetet anëtare, të pranuar tashmë edhe në MSA.

Politikat ekonomike të Shqipërisë janë përpara shumë sfidave, të cilat lidhen me nevojën për përmirësimin e klimës së biznesit, përmirësimin e trajnimit dhe edukimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet zbatimit të standardeve që nxisin studimin, novacionet dhe aftësinë krijuese në biznes, si dhe me domosdoshmërinë për të rritur aftësitë e ekonomisë shqiptare, për t'u përshtatur me logjikën e ndërkombëtarizimit dhe integrimit ne tregjet botërore, nëpërmjet rritjes së llojshmërisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe prodhimit të produkteve me vlerë të shtuar.

Në përcaktimin e vizionit për zhvillimin ekonomik në Shqipëri, Qeveria ka pranuar nevojën e bashkërendimit më të mirë midis institucioneve, të disa politikave ekonomike, si dhe klasifikimin e masave konkrete në bazë të prioriteteve, për të garantuar një zbatim sa më eficent të tyre. Imazhi i Shqipërisë si një vend për investime mbetet ende i varfër, infrastruktura është e prapambetur, mbështetja e SME-ve kërkon zhvillim të mëtejshëm. Gjithashtu kërkohet një strategji moderne e zhvillimit rajonal, e cila do të nxisë edhe më tej një rritje të balancuar, si dhe të ndikojë fuqishëm në krijimin e vendeve të reja të punës.

2.3. Strategjitë dhe planet e zhvillimit

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2008-2013 u miratua nga Këshilli i Ministrave në mars 2008. Strategjia përqendrohet në arritjen e një zhvillimi të balancuar, të harmonizuar dhe të qendrueshëm, në rritjen ekonomike dhe shtimin e punësimit. Strategjia synon, veçanërisht, ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës bazë, ndërtimin e një kuadri mbështetës për biznesin dhe rritjen e mundësive për punësim edhe për kategoritë në vështirësi, që do t'i shërbejnë përfshirjes së tyre në jetën shoqërore të vendit. Për përmbushjen e objektivave ekonomikë afatmesme, strategjia parashikon një sërë nismash që synojnë rritjen e qëndrueshme ekonomike, prodhimin dhe rritje të aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve, përmes zhvillimit dinamik të tyre, nxitjen e investimeve dhe përdorimin sa më efiçent të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare.

Duke qenë se këto nisma parashikohet të zbatohen në vitet e ardhëshme, realizimi i tyre mund të kërkojë skema të tjera të ndihmës shtetërore. Sipas, raportit edhe pse ndihma shtetërore në Shqipëri është në nivele të ulta (vetëm 1,2% e GDP), potencialisht ajo do të rritet, si rezultat i zhvillimit ekonomik që synohet të arrihet dhe si rezultat i zbatimit të strategjive sektoriale, duke përfshirë dhe politikat industriale, të turizmit dhe zhvillimit rajonal. Duhet theksuar, gjithashtu, se kjo strategji nënvizon edhe angazhimin e Qeverisë, duke përcaktuar në të prioritete edhe për forcimin e strukturave të kontrollit të ndihmës shtetërore në vend.

2.4. Objektivat për zhvillimin e sektorëve të veçantë në Shqipëri

Duke pasur parasysh prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2008-2013), në paragrafët e mëposhtëm jepen disa nga çështjet kryesore të politikës së Qeverisë për zhvillimin ekonomik, të cilat mund të ndikojnë, në vitet e ardhëshme, në ndërmarrjen e nismave të reja, ku mund të përfshihen skema të reja të ndihmës shtetërore, amendim i atyre ekzistese ose ndërhyrje "ad-hoc".

Transporti

Shqipëria përballet me sfida në sektorin e transportit, të tilla si: përfundimi i investimeve në rrjetin kombëtar rrugor, rrugët lokale dhe ato rurale, si dhe nxitja e ndërtimit të infrastrukturës rrugore, nëpërmjet koncesioneve. Përmirësimi i porteve, duke rehabilituar dhe zgjeruar infrastrukturën dhe superstrukturën, privatizimin e shërbimeve, si dhe pajisjen me teknologji bashkëkohore, nëpërmjet koncesioneve, është, gjithashtu, ndër objektivat kryesore. Durrësi, si porti kryesor në vend, duhet të zhvillohet në bazë të një plani prioritetesh, që aktualisht është në proces përgatitjeje. Për sa i takon sektorit hekurudhor, Shqipëria ka marrë përsipër detyrimin për ta ristrukturuar atë, për të përmirësuar menaxhimin, marketingun dhe situatën fianciare të Hekurudhës Shqiptare, si dhe për të moderinizuar infrastrukturën hekurudhore dhe "rolling stock" të cilat janë në kushte shumë të vështira. Prioritetet qeveritare për transportin ajror përfshijnë edhe shqyrtimin e mundësisë së krijimit dhe zhvillimit eficient të një transporti ajror të brendshëm.

Energjia

Prodhimi dhe furninizimi me energji është një problem serioz që daton që prej vitit 1990. Megjithatë vendi ka kaluar kriza mjaft të forta energjitike në vitet 2002 dhe 2005-2007. Në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, aktualisht, ka probleme mjaft të mëdha strukturore. Konkretisht, rrjeti ekzistues është i papërshtatshëm, pjesa më e madhe e humbjeve ndodh gjatë transmetimit dhe shpërndarjes, ka vështirësi për matjen e energjisë për konsumatorët individualë, biznese ose familjarë. Ndërsa pagesa e faturave po shkon drejt përmirësimit, por ritmi është ende i ulët. KESH ka bërë një ristrukturim të pjesshëm (për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen), por ende nuk është privatizuar. Ky problem madhor për vendin ka bërë të domosdoshëm përdorimin e një sërë skemash të subvencionit në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, të tilla, si:

- Subvencioni për konsumatorët me të ardhura të ulta, për t'i kompensuar rritjen e tarifës së energjisë, gjatë ristrukturimit të KESH-it;
- Mbështetje për KESH sh.a për të përballuar çmimin e importeve të energjisë[8];
- Shlyerja e detyrimeve të ndërsjellta, të prapmbetura, ndërmjet ndërmarrjeve me kapital shtetëror.

Zhvillimi rajonal

Përveç klasifikimit që ka Shqipëria në kuadrin Europian, si një vend i prapambetur, ajo ka probleme serioze edhe me pabarazinë rajonale brenda vendit. Prandaj, Qeveria, e bazuar në shqetësimin për pabarazinë ekonomike dhe sociale që ekziston midis zonave të ndryshme të vendit, ka përcaktuar si të domosdoshme përgatitjen e një politikë rajonale, integruese dhe koherente, duke vënë theksin tek zonat e thella malore dhe ato të prapambetura.

Në përgjigje të sfidave për zhvillimin rajonal të Shqipërisë, Qeveria ka marrë përsipër të zhvillojë dhe të zbatojë një Program Kombëtar për Zhvillimin e Qarqeve, si dhe të mbështesë zonat e prapambetura, nëpërmjet një Programi Zhvillimi për Zonat e Prapambetura, me qëllim që edhe ato të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrueshmërinë në vend.

Investimet e huaja të drejtpërdrejta

Megjithëse investimet e huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri janë rritur vitet e fundit, vendi vuan ende nga një imazh i varfër. Kjo shprehet në kërkesat e vazhdueshme për përmirësimin e klimës së biznesit dhe zgjidhjen e problemeve aktuale, sikurse është mungesa e furnizimit me energji.

Qeveria është angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit, falë reformave të ndërmarra, duke përfshirë projektet koncesionare, zbatimin e nismës "Shqipëria 1 euro", zhvillimin e partneritetit privat-publik, nxitjen e krijimit të zonave të lira dhe parqeve industriale,

[8] 50% e energjisë në Shqipëri në vitin 2007 është importuar, për shkak të ndikimit të thatësirës mbi gjëndjen e liqeneve dhe prodhimin e energjisë nga burimet hidrike. Këto të fundit mbulojnë rreth 90% të prodhimit të energjisë në Shqipëri.

zhvillimin e teknologjisë së informacionit në qendrat urbane dhe, më pas, edhe në zonat rurale, si dhe përshpejtimin e procesit të privatizimit të sektorëve strategjikë të vendit, si në sektorin energjetik, në sektorët e naftës dhe gazit dhe në sektorin e transportit.

Zhvillimi i SME-ve

Ndërmarrjet e vogla e të mesme (SME-të) përbëjnë rreth 90% të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri dhe punësojnë rreth 60% të të punësuarve. Sipas të dhënave për zhvillimin ekonomik në vend, sfidat me të cilat përballen SME-të janë thelbësore, duke përfshirë këtu aftësitë menaxhuese, nivelet e trajnimit për punonjësit, çështje që lidhen me kushtet e biznesit, rritja e mundësive për export, sigurimi i burimeve financiare, nxitja e novacionit dhe përdorimit të teknologjive të reja.

Nga ana tjetër, është e domosdoshme që të rritet kontributi ekonomik i SME-ve në Shqipëri dhe që ato të mbështeten me shërbime, duke iu krijuar mundësinë për infomacion dhe teknologjitë e komunikimit. Qeveria, në kuadër të një programi për SME-të, do të ndërmarrë masat e mëposhtme:

- Harmonizimin me strategjitë sektoriale që kanë ndikim në zhvillimin e SME-ve;
- Zhvillimin e një kulture sipërmarrjeje, nëpërmjet futjes së koncepteve të sipërmarrjes në programet mësimore bazë në të gjitha nivelet arsimore (por sidomos në shkollat profesionale);
- Zbatimi i kurseve të trajnimit për të rinjtë, të cilët kërkojnë të hapin një biznes;
- Përmirësimin e mbështetjes financiare, përmes mbështetjes së institucioneve të mikrokredisë, fondit të garantimit të kredive, si dhe përdorimit të instrumenteve të tjera financiare si “factoring” dhe “leasing”.

Politikat e punësimit

Tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga një normë punësimi jo më të lartë se 14%, që paraqet një përmirësim të ngadaltë gjatë këtyre tre viteve të fundit. Rritja më e madhe e vendeve të reja të punës është vënë re në sektorin e minierave, industrinë përpunuese dhe atë të shërbimeve. Të papunët për periudha afatgjata vazhdojnë të zënë 65% të numrit total të të papunëve në Shqipëri. Në këto kushte, zhvillimi i tregut të punës paraqet ende vështirësi për shkak të ritmit të ulët të krijimit të vendeve të reja të punës, shkallës së lartë të papunësisë midis të rinjve, dhe numrit të madh të të papunëve për një kohë të gjatë.

Qeveria është duke përgatitur një strategji të punësimit dhe formimit profesional, e cila ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj të papunëve dhe punëdhënësve, nëpërmjet masave të ndryshme, ku përfshihen përmirësimi i shërbimit të punësimit dhe zbatimi sa më efikas i programeve aktive dhe pasive të tregut të punës.

Turizëm

Sektori i turizmit në Shqipëri është zhvilluar në mënyrë të ndjeshme në vitet 2006 dhe 2007, gjë që shprehet edhe me rritjen e numrit total të vizitorëve. Për më shumë se shtatë vjet, sektori i turizmit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në eksport, duke u llogaritur që ka mbuluar mesatarisht në 77% të vlerës së përgjithshme të eksporteve.

Megjithë potencialin e madh, zhvillimi i turizmit është kushtëzuar nga infrastruktura e dobët në disa zona, nga burimet njerëzore të patrajnuara, si në sektorin publik ashtu dhe atë privat, si dhe nga problemet e pronësisë ende të pazgjidhura.

Me masat që do të merren, duke përfshirë marketingun, zhvillimin e produkteve, investimin dhe trajnimin sektorial, parashikohet që deri në vitin 2013, të arrihet një rritje prej më shumë se 300% e numrit total të vizitorëve dhe të të ardhurave nga turizmi.

Kulturë

Qeveria Shqiptare e konsideron kulturën si një mekanizëm që do të ndikojë fuqishëm në zhvillimin demokratik të vendit dhe në riafirmimin e identitetit kulturor shqiptar si në rajon, ashtu edhe si pjesë përbërëse e identitetit kulturor evropian.

Në veçanti, trashëgimia kulturore është pjesa më e rëndësishme e artit, kulturës dhe traditave shqiptare. Në të dy format e saj, materiale dhe shpirtërore, ajo provon edhe faktin se ky identitet i përket trashëgimisë europiane.

Për të forcuar dhe përmirësuar standardet e menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe duke u mbështetur në politikën komunitare “Të bashkuar në diversitet”, Qeveria ka si qëllim të ndërmarrë një sërë masash për të mbështetur kulturën dhe trashëgiminë, duke u fokusuar në mbështetjen për krijuesit shqiptarë dhe zgjerimin e industrive krijuese, krijimin e lehtësirave fiskale

për produktet kulturore dhe prezantimin e vlerave kulturore të Shqipërisë në vendet e Europës dhe më gjerë. Kjo do të realizohet nëpërmjet publikimeve të punëve të shkruara nga përfaqësues të njohur të literaturës tradicionale dhe moderne në gjuhë të ndryshme, si dhe pjesëmarrjen e shkrimtarëve, publikuesve, artistëve dhe producentëve të filmave artistikë e kulturorë në festivalet ndërkombëtare, panaire apo ekspozita.

KAPITULLI 3

3. KUADRI LIGJOR DHE DETYRIMET NDËRKOMBËTARE

Detyrimet e Shqipërisë për një sistem rregullator transparent lidhur me ndihmat shtetërore dhe subvencionet (duke përfshirë edhe raportimet) rrjedhin nga MSA-ja[9], MP[10], Vendimi i Partneritetit Europian[11] i nëntorit 2007, Marrëveshja e OBT-së për subvencionet dhe masat kundërbalacuese[12] dhe Marrëveshja e CEFTA-s (2006)[13].

3.1. Detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për rregullimin e ndihmave shtetërore në Shqipëri.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit u nënshkrua më 12 qershor 2006. Neni 71 i MSA-së "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike" parashikon zbatimin e të gjitha rregullave të Traktatit të Komunitetit Europian për ndihmën shtetërore në Shqipëri. Në thelb, ky nen përcakton detyrimin e Shqipërisë për të zbatuar (pas një periudhe të përcaktuar tranzicioni) të gjitha rregullat dhe rregulloret e BE-së në fushën e ndihmës shtetërore. Dispozitat kryesore të përcaktuara në nenin 71 të MSA-së për ndihmën shtetërore janë:

1. Çdo ndihmë shtetërore, e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e produkteve të caktuara, nuk është në përputhje me MSA-në, për sa kohë që ajo ka ndikim në tregtinë midis BE-së dhe Shqipërisë.

2. Çdo ndihmë shtetërore në kundërshtim me nenin 71 do të vlerësohet sipas kritereve të vendosura në bazë të nenit 87 të Traktatit të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretative të miratuara nga institucionet e BE-së për zbatimin e nenit 87 të Traktatit;

3. Shqipëria duhet të krijojë (brenda katër vjetësh) një autoritet për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore në Shqipëri që të funksionojë i pavarur. Ky autoritet duhet të ketë kompetencat për të miratuar dhënien e ndihmave shtetërore si dhe, në rast se është e nevojshme, të urdhërojë rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.

4. Secila nga palët, BE-ja dhe Shqipëria, duhet t'i paraqesë palës tjetër një raport të rregullt vjetor për situatën për ndihmën shtetërore.

5. Shqipëria do të hartojë një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës që kanë qenë në fuqi para ngritjes së autoritetit (ndihmat shtetërore ekzistuese) dhe, brenda katër vjetësh, të bëjë vlerësimin e tyre dhe të sigurojë përputhshmërinë e skemave me standardet e BE-së.

6. Me qëllim aplikimin e intensitetit maksimal të lejuar të ndihmës, Shqipëria do të konsiderohet si një vend me prapambetje të theksuar për një periudhë dhjetë vjeçare;

7. Brenda pesë viteve, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane të dhënat e GDP-së të harmonizuara në nivelin NUTS II, për përgatitjen e hartës rajonale të ndihmës shtetërore në Shqipëri, që do të marrë parasysh nevojat për kufij të ndryshëm të intensitetit të ndihmës së lejuar, në funksion të zonave të ndryshme brenda vendit.

---

[9] Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare të tij, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, e nënshkruar më 12 Qershor 2006.

[10] Marrëveshja e Përkohëshme mbi Tregtinë dhe Marrëdhëniet Tregtare midis Komunitetit Europian, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, OJ L 239 më 1 Shtator 2006.

[11] Vendim i Këshillit të BE-së për parimet, prioritetet dhe kushtet e vendosura në Partneritetin Europian me Shqipërinë dhe vendimin që e ka shfuqizuar 2006/54/EC, COM(2007) 656 përfundimtar, më 6 Nëntor 2007.

[12] Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalacuese, 1994: GATT Secretariat (1994): Rezultatet e Negociatave tregtare Multilaterale në Uruguaj, Teksti ligjor, Gjenevë, "Marrëveshja mbi Subvencionet dhe Masat Kundërbalacuese", fq. 264-314.

[13] Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (2006) -Marrëveshje për Ndryshimet dhe Hyrjen e Tregtisë së Lirë për Vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore (CEFTA 2006) në http://www.stabilitypact.org/t2/TradeCEFTA2006.asp.

8. Shqipërisë i është lejuar një periudhë tranzitore prej 5 vjetësh për ndihmë shtetërore në sektorin e çelikut, për të kryer ristrukturimin e mëtejshëm të kësaj industrie.

Siç shihet pika 4 përcakton detyrimin e përbashkët të palëve për raportim të rregullt të ndihmave shtetërore. Në fakt, MSA-ja kërkon transparencë ndërkombëtare lidhur me masat që lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore, të ndërmarra nga autoritetet në nivel qendror e vendor, si dhe nga institucionet që veprojnë në emër të shtetit. Megjithëse BE-ja ka kohë që paraqet raportet e detajuara vjetore për ndihmat shtetërore në territorin e saj, procesi i transparencës në këtë drejtim, për Shqipërinë, sapo ka filluar. Raportet e ardhshme do të jenë në gjëndje të tregojë në mënyrë më të plotë dhe me përpikmëri më të madhe përmirësimin e bërë në kohë dhe familjarizimin me procesin, në të gjitha nivelet e qeverisjes në Shqipëri.

3.2. Marrëveshja e përkohëshme dhe partneriteti europian

Zbatimi i plotë i MSA-së kërkon ratifimin e saj nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Megjithatë, disa kërkesa kanë filluar me përparësi nga zbatimi, në bazë të Marrëveshjes së përkohshme, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006. Kështu, në nenin 37 të Marrëveshjes së përkohshme parashikohen të njëjtat masa të përcaktuara në nenin 71 të MSA-së.

Vendimi i Partneritetit Europian i nëntorit 2007 nënvizon, ndër të tjera, domosdoshmërinë e miratimit të rregulloreve dhe akteve të tjera në zbatim të ligjit të ndihmës shtetërore, si dhe plotësimin e vazhdueshëm të inventarit të skemave të ndihmës shtetërore. Për periudhën afatmesme, Vendimi i Partneritetit Europian përcakton si përparësi zhvillimin e mëtejshëm të strukturave në drejtim të kontrollit të zbatimit të ligjit dhe përfundimin e përshtatjes së skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore me rregullat e BE-së. Prioritetet e MP-së për periudhën afatshkurtër pritet të realizohen në fund të vitit 2009 dhe prioritetet për periudhën afatmesme në fund të vitit 2011.

3.3. Detyrimet në kuadër të CEFTA-s për rregullimin e ndihmave shtetërore në Shqipëri

Marrëveshja paraqet një sërë detyrimesh të reja për Shqipërinë, duke përfshirë edhe detyrimet për ndihmën shtetërore. Përveç aspekteve të tjera të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë, CEFTA i referohet në mënyrë të veçantë fushës së ndihmës shtetërore në nenin 21, ku dhe shtjellohet kjo pikë. Marrëveshja e CEFTA-s në thelb e ndalon përdorimin e ndihmës shtetërore që mund të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar produkte të caktuara (me përjashtim të produkteve bujqësore), në atë masë që mund të sjellë ndikim në tregtinë midis vendeve, të cilat janë palë në Marrëveshje. Parimet që do të zbatohen për të vlerësuar praktikat që mund të thyejnë rregullat e vendosura në Marrëveshje, janë rregullat për ndihmën shtetërore në BE, të përcaktuara në nenin 87 të Traktatit të KE-së. Për më tepër, CEFTA përcakton se të gjitha vendet, palë të Marrëveshjes, janë të detyruara të sigurojnë transparencë në lidhje me ndihmat shtetërore, duke raportuar çdo vit për shumën e përgjithshme dhe shpërndarjen e ndihmës së dhënë. Secila nga palët e CEFTA-s, sipas kërkesës, kërkon informacion për skemat e ndihmës dhe rastet individuale të ndihmës shtetërore[14]. Së fundi, në vitin 2010, të gjitha palët e CEFTA-s duhet të kenë krijuar autoritetet funksionalisht të pavarura për kontrollin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Kështu, Marrëveshja e CEFTA-s paraqet në mënyrë të qartë një detyrim për Shqipërinë, për krijimin e një sistemi për regjistrimin e ndihmës shtetërore (inventari) dhe raportimin vjetor për ndihmën shtetërore të dhënë.

3.4. Detyrimet në kuadër të OBT-së për rregullimin e ndihmave shtetërore dhe subvencioneve në Shqipëri

Me anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), Shqipëria duhet të përmbushte detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e 1994 "Për subvencionet dhe masat kundërballancuese" (SCMA), të zbatonte rregullat e suvencionimit, të përcaktuara në Marrëveshjen për Bujqësinë, si dhe dispozitat e GATT 1994, që lidhen me aktivitetet tregtare të ndërmarrjeve shtetërore dhe ndërmarrjeve të tjera me të drejta të veçanta apo ekskluzive.

Kuptimi i "subvencionit" sipas Marrëveshjes për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese është i njëjtë me kuptimin e "ndihmës shtetërore" sipas legjislacionit të KE-së. "Njoftimet" e

[14] Paragrafi 7 i nenit 21 të Aneksit I të Marrëveshjes shprehet: "Secila palë siguron transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, inter alia, duke raportuar çdo vit tek Komiteti i Përbashkët për shumën e përgjithshme dhe shpërndarjen e ndihmës së dhënë dhe duke u dhënë palëve të tjera, sipas kërkesës, informacion për skemat e ndihmës dhe rastet e veçanta të ndihmës shtetërore."

përcaktuara në nenin 25 të Marrëveshjes për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese përfshijnë raportimin ndërkombëtar të subvencioneve kombëtare. Raporti i detajuar për subvencionet industriale ekzistuese është një kërkesë standarde në sistemin e OBT-së, të cilën Shqipëria e realizoi në Mars 2008. Megjithëse detyrimet për raportim të përcaktuara në CEFTA dhe MSA janë pothuajse të njëjta, OBT-ja mund të kërkojë një informacion më të detajuar për disa kategori ndihmash shtetërore/subvencionesh, ndonëse qëllimi i raportimit për subvencionet, sipas OBT-së, nuk parashikon të përfshijë sektorin e shërbimeve. Në të njëjtën kohë, pajtueshmëria e plotë me këto detyrime, nënkupton funksionimin e një sistemi kombëtar të marrjes dhe përditësimit të të dhënave, që tashmë është krijuar në Shqipëri.

KAPITULLI IV

4. NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NDIHMAVE SHTETËRORE NË SHQIPËRI

4.1. Ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të ndihmave shtetërore në Shqipëri

Në Shqipëri, është në fuqi një kuadër i plotë ligjor në fushën e ndihmës shtetërore. Ligji nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore" dhe tre rregulloret në zbatim të tij, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, përkatësisht:

- Rregullorja "Për procedurat dhe formën e njoftimit";
- Rregullorja "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale";
- Rregullorja "Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim", janë në fuqi që nga janari i vitit 2006.

Për zbatimin sa më të drejtë të ligjit, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka miratuar rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore", udhëzimin "Për disa kategori të ndihmave horizontale, udhëzimin "Për paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme", si dhe udhëzimin "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik".

Legjislacioni i Ndihmës Shtetërore në Shqipëri është në përputhje me rregullat e BE-së. Përveç përcaktimit të parimeve dhe procedurave, mbi bazën e të cilave duhet të jepet dhe të kontrollohet ndihma shtetërore, ai synon të vendosë një balancë midis politikave, të cilat kanë si qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të disa rajoneve ose të të gjithë vendit dhe të atyre që lidhen me mbrojtjen e parimeve të ekonomisë së tregut.

Sipas Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, reforma ligjore në fushën e ndihmës shtetërore do të vazhdojë me përgatitjen dhe miratimin e udhëzimeve dhe rekomandimeve të tjera, duke siguruar jo vetëm zbatimin sa më të mirë të kuadrit ligjir, por njëkohësisht edhe pasqyrimin e reformave të reja që po ndërmerren nga Komisioni Europian në këtë fushë.

Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", parashikon ngritjen e strukturave përgjegjëse për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri – Drejtoria e Ndihmës Shtetërore (DNSH) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH).

Komisioni i Ndihmë Shtetërore, i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave nr.182, datë 21.3.2006, është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë caktuar për një periudhë 4-vjeçare. KNSH ka kompetencë të autorizojë, me ose pa kushte, skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale në Shqipëri, apo të mos i miratojë ato. Gjithashtu, ai ka kompetencë të urdhërojë kthimin e çdo ndihme të dhënë në mënyrë të paligjshme. KNSH vepron në zbatim të procedurave të ligjit, rregulloreve në zbatim të tij, si dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore".

DNSH është krijuar në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr.79, datë 26.3.2004. Detyrat kryesore të Drejtorisë janë: përgatitja e kuadrit ligjor (duke përfshirë çdo ndryshim të ardhshëm, rregulloret e reja, udhëzimet, etj.), analiza dhe vlerësimi ekonomik dhe juridik i skemave të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale, si dhe përgatitja e raporteve vlerësuese për rastet konkrete. DNSH kontribuon në vendimmarrjen e KNSH, nëpërmjet analizës për procesin e përpilimit dhe zhvillimit të politikave rajonale dhe sektoriale.

Detyrimet ligjore të DNSH-së dhe kompetencat e KNSH-së, krahas mënyrës së raportimit dhe

kalimit të informacionit midis tyre, sigurojnë pavarësinë funksionale gjatë fazës tranzitore, të përcaktuar në nenin 71, pika 4 të MSA-së (Neni 37, pika 4 e Marrëveshjes së përkohshme).

4.2 Progresi i bërë deri tani në zbatimin e ligjit "Për ndihmën shtetërore"

Në zbatim të kuadrit ligjor të sipërpërmendur, strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore në Shqipëri e kanë përqendruar punën e tyre në dy drejtime kryesore: shqyrtimi dhe vlerësimi i skemave ekzistuese, pjesë e inventarit të ndihmave shtetërore, si dhe ndjekja e të gjitha procedurave për dhënien e miratimin e planeve të reja për ndihmë shtetërore.

Veç kësaj, DNSH ka qenë shumë aktive në rishikimin dhe dhënien e mendimeve për projekt-aktet e ndyshme normative që mund të përmbanin elemente të ndihmës shtetërore, nëpërmjet përfshirjes së burimeve shtetërore, siç janë masat e reja fiskale, legjislacioni zbatues për administrimin e pronave publike, projektaktet që lidhen me shërbimet publike, aktet normative në fushën e turizmit, shëndetësisë, punësimit, etj.

I gjithë ky proces ka bërë të mundur një njohje më të plotë të rregullave dhe kritereve të ndihmës shtetërore nga ana e dhënësve të ndihmës, si dhe ndërgjegjësimin e tyre për zbatimin e detyrimeve ligjore në fushën e ndihmës shtetërore. Procesi i vlerësimit dhe vendimmarrjes për çështjet e ndihmës shtetërore është paraprirë nga një sërë tryezash të rrumbullakta, workshop-esh dhe konsultimesh me dhënësit e ndihmës në nivel qendror dhe vendor.

Ndonëse Shqipëria është e detyruar, për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare, të kontrollojë subvencionet dhe ndihmat shtetërore sipas normave dhe praktikave ndërkombëtare, ngritja e këtij sistemi duhet parë në një këndvështrim dhe dimension kombëtar, pra që është i përshtatshëm për Shqipërinë dhe pothuajse i pavarur nga ndërhyrjet e jashtme. Në veçanti, skemat e ndihmës shtetërore në Shqipëri po shihen si një mundësi për të krijuar lehtësira, nëpërmjet përdorimit sa më eficent të burimeve tepër të kufizuara shtetërore, në kuadër të programeve të zhvillimit brenda vendit, si dhe të ndihmojnë në parandalimin apo shmangien e keqpërdorimit të fondeve publike.

4.3. Një vështrim mbi skemat ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri

Neni 71, pika 6 e MSA-së dhe neni 37, pika 6 i MP-së, detyrojnë sigurimin e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Për këtë, është kërkuar përgatitja e një inventari gjithëpërfshirës të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore (skema, që janë miratuar para hyrjes në fuqi të legjislacionit të ndihmës shtetërore dhe kanë gjetur zbatim edhe pas 1 janarit të vitit 2006).

DNSH ka punuar për më tepër se dy vjet për përgatitjen e një liste të masave që do të përfshiheshin në inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore, së bashku me informacionin e detajuar për to. Pasi klasifikoi dhe regjistroi të gjitha masat që përmbanin elementë të ndihmës shtetërore, DNSH vijoi me përgatitjen e raporteve vlerësuese për çdo skemë, si dhe të projekt-vendimeve për KNSH-në, me qëllim përshtatjen e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore me kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

Pas shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve për secilën nga skemat e regjistruara në inventar, KNSH dhe DNSH, në bazë të neneve 17 (d) dhe 18 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", kanë përgatitur raportin "Për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri", i cili pasi u miratua nga Këshilli i Ministrave, iu përcoll shërbimeve të Komisionit Europian[15] .

Skemat ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri përfshijnë ligje dhe vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat mundësojnë, nëpërmjet burimeve shtetërore, mbështetjen në sektorë, të tillë si: sektori i ujësjellës-kanalizimeve, transporti hekurudhor i udhëtarëve, energjia dhe sektori i hidrokarbureve, industria minerare, turizmi, punësimi, shëndetësia, etj.

Gjatë këtij procesi, u vu re se mbështetja nga ana e shtetit bëhet nuk bëhet vetëm nëpërmjet subvencionimit të drejtpërdrejtë, por edhe nëpërmjet formave të tjera të ndihmës, siç janë: lehtësirat e ndryshme fiskale, përjashtimi nga taksat dhe detyrimet doganore, shtyrja e pagesave apo shlyerja e detyrimeve të prapambetura, etj.

Autoritetet shqiptare kanë rishikuar dhe vlerësuar përputhshmërinë e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore sipas legjislacionit shqiptar për ndihmën shtetërore. Ky proces është udhëhequr nga puna analitike e DNSH-së dhe vendimet përkatëse të KNSH-së.

---

[15] Raporti "Për Inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri", është miratuar me VKM nr. 45, datë 16.01.2008, dhe publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Rishikimi dhe përshtatja e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri, ka bërë të mundur përgatitjen dhe miratimin e kuadrit të ri ligjor për turizmin, koncesionet dhe zonat e lira, si dhe vendimeve të reja të Këshillit të Ministrave për skemat e ndihmës për punësim. Përpjekje po bëhen gjithashtu për zbatimin e masave të propozuara nga KNSH për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe sektorin e transportit hekurudhor

Në këto kushte, mund të thuhet se procesi i rishikimit të skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe përshtatja e tyre me rregullat e ndihmës shtetërore është përmbushur në një masë të madhe.

4.4. Skemat e reja të ndihmës shtetërore

Gjatë vitit 2007, Drejtoria e Ndihmës Shtetërore ka analizuar, gjithashtu, edhe 4 plane të reja të ndihmës shtetërore, për të cilat KNSH ka dhënë vendimet përkatëse.

Programi i praktikave profesionale

Skema "Për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit", e njoftuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka si qëllim përgatitjen e fuqisë punëtore, në veçanti të të rinjve, nëpërmjet programeve aktive, të cilat do të ndikojnë në rritjen profesionale të tyre dhe do t'i integrojnë ata në tregun e punës.

Fondi Shqiptar i Konkurueshmërisë

Qëllimi i skemës "Për krijimin e Fondit Shqiptar te Konkurueshmërisë", është rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri, nëpërmjet rritjes së cilësisë së prodhimit e menaxhimit, nxjerrjes së produkteve që të përmbushin kërkesat e standardeve të tregut Rajonal dhe Europian dhe integrimin e tyre në këto tregje

Fondi i garantimit të kredive të eksportit

Skema tjetër e njoftuar nga Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, "Për fondin e garantimit të kredive të eksportit", ka si qëllim kryesor financimin për eksportuesit shqiptarë dhe rritjen e shkallës së konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare. Skema parashikohet të lëshojë garanci për eksportuesit, kur ata kanë nevojë për financime afatshkurtra, për të vendosur eksportesit vendas në të njëjtat kushte me firmat e huaja.

Shtyrja e pagesës së TVSH-së

Për sa i takon planit "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a", të njoftuar nga Ministria e Financave, KNSH, në bazë të raportit vlerësues të DNSH-së, vendosi miratimin e skemës me kushte.

Duhet theksuar se dhënësit e ndihmës, përgjithësisht, janë konsultuar me DNSH që në procesin e hartimit të këtyre skemave, me qëllim përgatitjen e tyre në përputhje me kriteret e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ky bashkëpunim ka lehtësuar vlerësimin e planeve dhe miratimin e mëtejshëm të tyre nga KNSH.

Në bazë të ligjit "Për ndihmën shtetërore", të gjitha vendimet e KNSH-së u janë bërë të njohura dhënësve të ndihmës dhe janë publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Tabela 2 paraqet, në mënyrë të përmbledhur, të gjitha skemat ekzistuese të ndihmës shtetërore dhe planet e reja të ndihmës të analizuara nga DNSH, si dhe vendimet përkatëse të KNSH-së.

Tabela 2: Vendimet e KNSH për skemat ekzistuese, skemat e reja dhe ndihmat individuale

Nr.	Nr. Regjistrit	Titulli i skemës	Sektori	Vendim KNSH
1	AI/011/2005	Për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit	Bujqësi	Nr. 2, datë 20.10.2006 Rekomandime
2	AI/010/2005	Për përjashtimin nga akciza e karburantit të përdorur në linjat e agropërpunimit	Bujqësi	Nr. 3, datë 20.10.2006 Rekomandime
3	AI/009/2005	Për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e përpunimit të qumështit, ullirit, rrushit dhe bluarjes së grurit	Bujqësi	Nr. 4, datë 20.10.2006 Rekomandime
4	AI/014/2005	Për subvencionimin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve	Ujësjellës-Kanalizime	Nr. 5, datë 20.10.2006 Masa të propozuara
5	AI/015/2005	Për subvencionimin e Hekurudhave	Transporti Hekurudhor	Nr. 8, datë 2.02.2007, Masa të propozuara Nr.15, dated 15.03.2007, Në fuqi masat e propozuara

6	Al/N/001/2006	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për shtëpinë botuese "Naim Frashëri"	Kultura	Nr. 6, datë 20.10.2006 Nuk është miratuar
7	Al/N/002/2006	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit	Punësimi	Nr. 9, datë 02.02.2007 Miratuar
8	Al/N/003/2007	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin "për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë	SME	Nr. 10, datë 2.02.2007 Miratuar me kushte
9	Al/006/1/2005	Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë	Punësimi	Nr. 11, datë 15.03.2007, Masa të propozuara për rishikim tërësor Skema u shfuqizua me VKM nr. 48, datë 16.01.2008
10	Al/006/2/2005	Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë	Punësimi	No. 12, dated 15.03.2007 Masa të propozuara për rishikim tërësor Skema u shfuqizua me VKM nr. 47, datë 16.01.2008 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"
11	Al/006/3/2005	Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional	Punësimi	Nr. 13, datë 15.03.2007, Masa të propozuara për rishikim tërësor Skema u shfuqizua me VKM nr. 47, datë 16.01.2008 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë"
12	Al/006/4/2005	Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra	Punësimi	Nr. 14, datë 15.03.2007, Masa të propozuara Skema u shfuqizua me VKM nr. 508, datë 08.08.2007 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra"
13	Al/N/004/2007	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "për fondin e garantimit të kredive të eksportit	SME	Nr. 16, datë 16.07.2007 Miratuar
14	Al/N/005/2007	Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe paisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a		Nr. 17, datë 16.07.2007 Miratuar me kushte
15	Al/004/2005	Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin	Turizëm	No.18, Dated 01.11.2007 Miratuar
16	Al/003/2005	Për koncesionet		No. 19, Dated 01.11.2007 Miratuar me kushte
17	Al/007/2005	Për zonat e lira	Zonat e lira	No. 20, dated 01.11.2007 Miratuar me kushte
18	Al/013/2005	Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror	Ujësjellës-Kanalizime/ Minierat në likuidim	No. 21, dated 01.11.2007 Masa të propozuara

KAPITULLI 5

5. NDIHMA SHTETËRORE NË SHQIPËRI

5.1. Vështrim mbi ndihmën shtetërore në Shqipëri në periudhën 2005-2007

Vlera e ndihmës shtetërore në Shqipëri për vitin 2007 llogaritet në 11.4 miliardë lekë. Nëse bëjmë krahasimin me secilin nga vitet 2005 (5 miliardë lekë) apo 2006 (5 miliardë lekë), kjo shumë është dyfishuar. Megjithatë, niveli i ndihmës shtetërore në ekonomi mbete ende i ulët, vetëm 1.2% e GDP për vitin 2007.

Tabela 3 paraqet treguesit kryesorë që lidhen me ndihmën shtetërore në Shqipëri për tre vitet e fundit (2005-2007).

Tabela 3: Ndihma shtetërore në Shqipëri (përfshirë bujqësinë dhe peshkimin) për vitet 2005-2007

Emërtimi	**Njësia e matjes**	**Viti**			**Indekset**		
		2005	**2006**	**2007**	**2005**	**2006/**	**2007/**
					100	2005	2005
kursi mesatar i këmbimit		122,54	123,70	121,78			
Ndihma shtetërore	milion LEK	5.041,22	5.036,87	11.442,67	100%	100%	227%
Ndihma shtetërore	milion Euro	41,14	40,70	93,96	100%	99%	228%
PPB nominal	milion LEK	836.600,00	896.300,00	956.314,00	100%	107%	114%
PPB nominal	milion Euro	6.736,00	7.286,00	7.885,00	100%	108%	117%

Ndihma shtetërore në raport ndaj PPB	**%**	**0,61%**	**0,56%**	**1,19%**	100%	91%	195%
Shpenzimet gjithsej	milion LEK	232.339,00	258.816,00	285.329,00	100%	111%	123%
Shpenzimet gjithsej	milion Euro	1.896,03	2.092,29	2.342,99	100%	110%	124%
Ndihma shtetërore në raport ndaj shpenzimeve gjithsej	%	2,17%	1,95%	4,01%	100%	90%	185%
Numri i të punësuarve	milion	0,932	0,934	0,935	100%	100%	100%
Ndihma shtetërore për cdo punonjës	LEK	5.409	5.393	12.238	100%	100%	226%
Ndihma shtetërore për cdo punonjës	Euro	44	44	100	100%	99%	228%
Numri i të papunëve	milion	0,1532	0,14976	0,159	100%	98%	104%
Ndihma shtetërore për cdo të papunë	LEK	32.906	33.633	71.966	100%	102%	219%
Ndihma shtetërore për cdo të papunë	Euro	269	272	591	100%	101%	220%
Inhabitants number	milion	3,063	3,15	3,25	100%	103%	106%
Ndihma shtetërore për frymë	LEK	1.646	1.599	3.521	100%	97%	214%
Ndihma shtetërore për frymë	Euro	13	13	29	100%	96%	215%

Të dhënat në tabelën 3 përfshijnë edhe ndihmën "de minimis"[16].

Nga këto të dhëna, vërehet se ka një tendencë rritjeje të nivelit të ndihmës shtetërore për çdo punonjës (afërsisht nga 5,400 lekë në 2005 dhe 2006 në 12,000 lekë në 2007) dhe të ndihmës për frymë (afërsisht nga 1,600 lek në 2005 dhe 2006 në 3,521 në 2007). Kjo prirje vihet re edhe për ndihmën shtetërore për personat e papunë, ku ndihma në vitin 2007 është gati sa dyfishi i vlerës së saj në vitet 2005 dhe 2006. Po kështu, është dyfishuar pjesa e ndihmës shtetërore në raport me shpenzimet totale të Qeverisë, për 3 vitet e fundit,.

Referuar metodologjsë së BE-së, ku ndihma shtetërore në bujqësi, peshkim dhe transport monitorohen dhe vlerësohen veçmas, në tabelën 4 paraqiten të dhënat e ndihmës shtetërore në Shqipëri, në 3 vitet e fundit, duke përjashtuar vlerën e dhënë për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit.

Table 4: Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2005-2007 (përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

Emërtimi	Njësia e matjes	2005	2006	2007
Ndihma shtetërore totale përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin: transportin publik dhe shërbimin ajror	million LEK	2.901,22	3.318,57	9.435,99
Ndihma shtetërore totale përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin: transportin publik dhe shërbimin ajror	million Euro	23,68	26,81	77,48
PPB Nominal	million LEK	836.600,00	896.300,00	956.314,00
PPB Nominal	million Euro	6.736,00	7.286,00	7.885,00
Ndihma shtetërore përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin ndaj PPB	%	0,351	0,368	0,983

Analiza tregon se, duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin, vlera e ndihmës shtetërore në vitin 2007 është 9.4 miliardë lekë. Në vitin 2006 vlera e ndihmës shtetërore (pa bujqësinë, pëshkimin dhe transportin) ishte 14% më e lartë se në 2005. Ndërsa në vitin 2007 ajo ishte gati 3 herë më e madhe (284%), krahasuar me shifrat e vitit 2006 dhe mbi 3 herë më e madhe (325%)

[16] Ndihma De Minimis, është ndihma shtetërore me vlerën më pak se 100.000 Euro dhe që jepet për një periudhë jo më të shumë se tre vjetësh. Sipas rregullave të BE-së, (ku, niveli më i lartë i ndihmës "de minimis" është 200,000€) ky nivel i mbështetjes nuk konsiderohet si masë që mund të sjellë ndikim në tregti.

se vlera e ndihmës së dhënë në vitin 2005.

Megjithatë, nëse krahasimin e bëjmë kundrejt treguesit të PPB-së, duke përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin (tabela 3) dhe pa i përfshirë këta sektorë, është e qartë se raporti ndihmë shtetërore/PPB ulet nga 1,2% në 0,987% për vitin 2007; me të njëjtën shkallë është ulja për vitin 2006, pra nga 0,56% në 0,37% dhe për vitin 2005, nga 0,61% në 0,35%. Kjo tregon se 27% të ndihmës shtetërore në 3 vitet e fundit e zë ndihma shtetërore për transport, bujqësi dhe peshkim.

Pjesa që zë ndihma shtetërore (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit) në raport me PPB-në përdoret nga BE për të bërë krahasimet midis shteteve, si dhe për të monituar prirjen e vlerës totale të ndihmës shtetërore (nëse rritet apo ulet). Parë në këtë këndvështrim, nivelet nga 0,35% në 0,61% janë të krahasueshme me mesataren e raportit ndihmë shtetërore/PPB për vendet e BE-së (pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin), që është në vlerat 0,4% për vitin 2004 dhe 2005 dhe 0,42% për vitin 2006[17]. Vlera prej 0,987% e vitit 2007 është më shumë se dyfishi i mesatares për vendet e BE-së. Krahasimi për vitet 2005 dhe 2006 jepet në tabelën 5.

Table 5: Ndihma shtetërore në Shqipëri në total krahasuar me mesataren në BE për vitet 2005-2006[18] (përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

	2005		2006	
	Ndihma totale pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin			
	mil Eur	në raport ndaj PPB në %	mil Eur	në raport ndaj PPB në %
Shqipëria	**23,7**	**0,35**	**26,81**	**0,37**
EU-25	47320,8	0,43	47903,3	0,42
EU-15	44238,8	0,42	44662,3	0,41
EU-10	3082,1	0,53	3241,1	0,52
BE	720,6	0,24	883,7	0,28
CZ	459,5	0,45	583,7	0,51
DK	1101,5	0,52	1020,7	0,46
DE	15226,0	0,68	16002,8	0,69
EE	15,1	0,13	10,7	0,08
IE	465,2	0,28	491,3	0,28
EL	257,9	0,13	318,5	0,15
ES	3865,1	0,41	3861,5	0,39
FR	7432,9	0,42	7381,9	0,41
IT	4522,6	0,31	3842,8	0,26
CY	137,9	0,99	70,0	0,48
LV	26,5	0,18	24,5	0,15
LT	33,2	0,15	53,5	0,23
LU	45,6	0,14	44,9	0,13

[17] http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm.

[18] Të dhëna nga BE-ja dhe shtetet anëtare të BE-së: http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_report.cfm.

HU	985,5	1,07	832,9	0,93
MT	121,8	2,50	88,9	1,77
NL	1213,1	0,23	1269,5	0,24
AT	998,2	0,40	1551,0	0,60
PL	921,0	0,37	1230,5	0,45
PT	1449,5	0,95	1417,6	0,91
SI	129,9	0,45	146,9	0,48
SK	251,8	0,64	199,3	0,45
FI	575,6	0,36	590,0	0,35
SE	2678,2	0,91	2889,7	0,94
UK	3686,7	0,20	3096,3	0,16

Nëse i referohemi vlerës totale të ndihmës (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit) të shprehur në Euro, tabela tregon se ndihma shetërore në Shqipëri për vitin 2005 ka qenë më e ulët se niveli i saj në secilin prej shteteve anëtare të BE-së. Krahasimi vlen edhe për shtetet e vogla anëtare, me popullsi të përafërt me atë të Shqipërisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vitin 2006, ku niveli ka qenë më i ulët se të gjitha shtetet, me përjashtim të Lituanisë. Ndihma shtetërore në Shqipëri në raport me PPB-në, gjithashtu ka qenë më e ulët se mesatarja e BE–së në të dyja vitet. Në vitin 2005, 10 shtete anëtare të BE-së e kishin raportin e ndihmës shtetërore kundrejt PPB-së më të ulët se vlera prej 0,35 % e këtij raporti për Shqipërinë. Në vitin 2006, ishin 11 shtete, të cilat e kishin këtë raport në nivele më të ulta se Shqipëria.

5.2. Kategoritë e ndihmës shtetërore

Duke ndjekur metodologjinë e BE-së për raportimin e ndihmës shtetërore, në këtë raport janë paraqitur të dhënat për kategoritë e mëposhtme të ndihmës shtetërore: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale), ndihma "Ad-hoc" dhe ndihma shtetërore për sektorët e bujqësisë dhe peshkimit.

Ndihma horizontale është e zbatueshme për të gjitha ndërmarrjet dhe sektorët dhe ka të ngjarë të shtrembërojë më pak konkurrencën në treg sesa ndihma për sektorët e veçantë apo ajo që u jepet vetëm disa ndërmarjeve që veprojnë në sektorë të caktuar të industrisë. Ndihma horizontale përfshin kategoritë që, kryesisht, synojnë të nxitin zhvillimin rajonal, kërkimin dhe zhvillimin, mbrojtjen e mjedisit dhe kursimin e energjisë, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, punësimin, trajnimin dhe kulturën.

Ndihma sektoriale i referohet ndihmës shtetërore që jepet për sektorë të veçantë, duke përfshirë sektorin e transportit, shërbimet publike, transmetimet televizive, minierat dhe turizmin.

Ndihma Ad-Hoc ose ndihma individuale është ndihma që projektohet për/dhe i jepet vetëm një ndërmarrjeje përfituese.

Ndihma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore, gjë që është përcaktuar edhe në MSA. Për periudhën tranzitore ajo raportohet apo shpjegohet nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Tabela 6 paraqet të dhënat për kategoritë e mësipërme të ndihmës shtetërore në Shqipëri, për periudhën 2005-2007.

Table 6 : Klasifikimi sipas kategorive i ndihmës shtetërore në Shqipëri, për vitet 2005-2007 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

		Kategoria e ndihmës	2005			2006			2007		
			Në milionë lekë	Në milionë Euro	(%)	Në milionë lekë	Në milionë Euro	(%)	Në milionë lekë	Në milionë Euro	(%)
		kursi mesatar i këmbimit	122.54				123.70			*121.78*	
A		**Ndihmat horizontale**	**773.20**	**6.31**	**15.34**	**1,022.20**	**8.26**	**20.30**	**2,674.44**	**21.96**	**23.37**
	1	Ndihma rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	2	Punësimi	120.35	0.98	2.387	68.25	0.55	1.355	77.60	0.64	0.678
	3	Kultura	206.50	1.69	4.096	225.00	1.82	4.469	121.07	0.99	1.058
	4	Mjedisi	-		-	-	-	-	-	-	-
	5	Eksporti	-		-	-	-	-	-	-	-

	6	Ndihma operacionale	76.29	0.623	1.513	71.74	0.58	1.425	67.56	0.55	0.590
	7	Shpëtimi dhe ristrukturimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	8	Kërkimi dhe Zhvillimi	285.89	2.33	5.671	545.09	4.41	10.826	317.60	2.61	2.776
	9	SME-të	-	-	-	-	-	-	2.40	0.02	0.021
	10	Sporti	70.10	0.57	1.391	80.00	0.65	1.589	48.61	0.40	0.425
	11	Trainimi	14.07	0.11	0.279	32.12	0.26	0.638	39.60	0.33	0.346
	12	Ndihma sociale për konsumatorë individualë	-	-	-	-	-	-	2,000.00	16.42	17.478
B	**Ndihma sektoriale (vertikale)**		**2,978.02**	**24.30**	**59.07**	**3,097.36**	**25.03**	**61.48**	**2,496.05**	**20.50**	**21.81**
	12	Transporti publik	850.00	6.94	16.861	801.00	6.48	15.908	734.50	6.03	6.419
	13	Shërbimet publike	1,766.93	14.42	35.050	2,083.20	16.84	41.373	1,619.13	13.30	14.150
	14	Minierat	304.29	2.48	6.036	158.00	1.28	3.138	-	-	-
	15	Energjia	53.94	0.44	1.070	50.31	0.41	0.999	120.66	0.99	1.055
	16	Audio-Vidio	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	17	Televizionet/mediat	2.86	0.02	0.057	2.86	0.02	0.057	2.86	0.02	0.025
	19	Turizmi	-			2.00	0.00196	0.0048	18.90	0.16	0.165
C	**Ndihma Individuale**		**-**	**-**		**-**	**-**		**5,000.00**	**41.06**	**43.696**
D	**Bujqësia**		**1,290.00**	**10.53**	**25.59**	**917.30**	**7.42**	**18.218**	**1,272.18**	**10.45**	**11.118**
		TOTALI	**5,041.22**	**41.14**	**100.00**	**5,036.87**	**40.70**	**100.00**	**11,442.67**	**93.96**	**100.00**

Siç vihet re në tabelën 6, për vitet 2005-2007, pjesën më të madhe e zë ndihma sektoriale (vertikale) me rreth 40% të vlerës totale. Ndihma për energjinë llogaritet në 2% të të gjithë ndihmës sektoriale për të njëjtën periudhë, megjithatë, po të shtojmë në të ndihmën "Ad hoc", vlera e ndihmës shtetërore për sektorin e energjisë shkon në 24% të vlerës totale të ndihmës shtetërore. Ndihma shtetërore për shërbimet publike, si: hekurudhat, energjinë (duke përfshirë dhe ndihmën Ad-hoc) dhe sektorin e ujësjellës-kanalizimeve mbizotëron në vlerën e përgjithshme të ndihmës shtetërore në Shqipëri, duke zënë 61% të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë gjatë periudhës 3 vjeçare.

Në vitin 2006, vlera e ndihmës horizontale është rritur me 30% krahasuar me 2005, ndërsa në vitin 2007 ajo u rrit edhe me 265%. Megjithatë, ndihma horizontale për vitin 2007 ka pësuar shmangie, si rezultat i zbatimit të një skeme të vetme, asaj të ndihmës me karakter social për konsumatorët individualë, që përbën 45% të ndihmës horizontale për të gjithë periudhën 3-vjecare. Kjo masë lidhet me subvencionin që iu është dhënë kategorive të veçanta të konsumatorëve (si p.sh të moshuarit), për përballimin e çmimit të energjisë, që pësoi rritje për shkak të rritjes së importit të energjisë gjatë vitit 2007. Nëse do të përjashtojmë këtë skemë, ndihma horizontale për vitin 2007 do të ishte më ulët se ajo e vitit 2005. Pavarësisht nga ndikimi i skemës për konsumatorët individualë, vlera e ndihmës horizontale në Shqipëri, sikurse u paraqit edhe më sipër, është në nivele të ulta.

Këto të dhëna paraqiten në figurën 1.

Figura 1: Ndihma shtetërore (në milion lekë) për vitet 2005, 2006 dhe 2007



Tabela 7 paraqet vlerat e ndihmës shtetërore për të gjitha kategoritë e përshkruara, duke përjashtuar ndihmën shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin.

Tabela 7: Klasifikimi sipas kategorive i ndihmës shtetërore në Shqipëri, për vitet 2005-2007 (përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

		Kategoria	2005			2006			2007		
			në mil LEK	në mil EUR	pjesa (%)	në mil LEK	në mil EUR	pjesa (%)	në mil LEK	në mil EUR	pjesa (%)
		kursi mesatar i këmbimit	122,54				123,70			121,78	
A	**Ndihmat horizontale**		**773,20**	**6,31**	**20,61**	**1.022,20**	**8,26**	**24,82**	**2.674,44**	**21,96**	**26,30**
	1	Ndihma rajonale									
	2	Punësimi	120,35	0,98	3,208	68,25	0,55	1,657	77,60	0,64	0,763
	3	Kultura	206,50	1,69	5,505	225,00	1,82	5,464	121,07	0,99	1,190
	4	Mjedisi									
	5	Eksporti									
	6	Ndihma operacionale	76,29	0,623	2,034	71,74	0,58	1,742	67,56	0,55	0,664
	7	Shpëtimi dhe ristrukturimi									
	8	Kërkimi dhe Zhvillimi	285,89	2,33	7,621	545,09	4,41	13,237	317,60	2,61	3,123
	9	SME-të							2,40	0,02	0,024
	10	Sporti	70,10	0,57	1,869	80,00	0,65	1,943	48,61	0,40	0,478
	11	Trainimi	14,07	0,11	0,375	32,12	0,26	0,780	39,60	0,33	0,389
	12	Ndihma sociale për konsumatorë individualë	-	-	-	-	-	-	2.000,00	16,42	19,665
B	**Ndihma sektoriale (vertikale)**		**2.978,02**	**24,30**	**79,39**	**3.097,36**	**25,03**	**75,18**	**2.496,05**	**20,50**	**24,54**
	12	Transporti publik	850,00	6,94	22,659	801,00	6,48	19,452	734,50	6,03	7,222
	13	Shërbimet publike	1.766,93	14,42	47,103	2.083,20	16,84	50,590	1.619,13	13,30	15,920
	14	Minierat	304,29	2,48	8,112	158,00	1,28	3,837			
	15	Energjia	53,94	0,44	1,438	50,31	0,41	1,222	120,66	0,99	1,186
	16	Audio-Vidio									
	17	Televizionet/mediat	2,86	0,02	0,076	2,86	0,02	0,069	2,86	0,02	0,028
	19	Turizmi				2,00	0,00196	0,00588	18,90	0,16	0,186
C	**Ndihma Ad hoc**			-					**5.000,00**	**41,06**	**49,162**
		TOTALI	**3.751,22**	**30,61**	**100,00**	**4.119,57**	**33,29**	**100,00**	**10.170,49**	**83,52**	**100,00**

5.3. Instrumentet e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore në Shqipëri jepet, kryesisht, në formën e granteve e faljes së detyrimeve, si dhe të përjashtimit e uljes së taksave, apo shtyrjes së pagesave. Kjo prirje paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, në tabelën 8.

Tabela 8: Ndihma shtetërore në Shqipëri e klasifikuar sipas instrumentave për vitet 2005-2007

Kategoria e Instrumenteve	Instrumentat e Ndihmës Shtetërore	Treguesit	2005	2006	2007
A1	Subvencione dhe Grante	*%*	*88,83*	*83,74*	*95,00*
		lek	3.332,24	*3.447,57*	*9.661,81*

		eur	27,19	27,87	21,68
A2	Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale	*%*	*11,09*	*16,19*	*4,32*
		lek	*416,12*	*667,14*	*439,08*
		eur	*3,40*	*5,39*	*3,61*
B	Pjesmarrja në kapital	*%*	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C1	Hua të buta	*%*	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C2	Të tjera instrumente	*%*	*0,08*	*0,07*	*0,68*
		lek	*2,859*	*2,859*	*70,26*
		eur	*0,02*	*0,60*	*0,58*
D	Garancitë	*%*	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-

Grupi “Instrumente të tjera (C2)" i referohet dhënies me qera të pronave shtetërore me çmime më të ulta se çmimi i tregut[19], në bazë të një skeme, e cila ishte shfuqizuar para hyrjes në fuqi të legjislacionit të ndihmës shtetërore[20]. Megjithatë, në tabelë janë paraqitur të dhënat për periudhën 2005-2007, pasi ka ende disa kontrata, të lidhura në kuadër të asaj skeme, që kanë efekt ligjor dhe, për rrjedhojë, ende vazhdojnë të zbatohen.

Përdorimi i instrumenteve të ndihmës shtetërore në Shqipëri është paraqitur në figurën 2.

Figura 2: Ndihma shtetërore sipas instrumentave (në milion lekë) për vitet 2005, 2006 dhe 2007



Edhe në Bashkimin Europian, instrumenti kryesor që përdoret është ndihma shtetërore në formën e granteve (50% të mesatares të totalit të ndihmës shtetërore në BE), që pasohet nga përjashtimet nga taksat dhe shtyrjet e pagesave (45% të mesatares të totalit të ndihmës shtetërore në BE)[21]. Siç shihet, vendi që zë secili prej instrumenteve të përdorura në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, përgjithësisht, është në përputhje me prirjet përkatëse në Bashkimin Europian.

[19] VKM nr. 430, datë 9.7.1998, “Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore”.

[20] VKM nr. 315, datë 24.4.2003.

[21] Të dhëna nga BE për periudhën 2004-2006:
http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm

5.4. Klasifikimi i ndihmës shtetërore në Shqipëri

5.4.1. Ndihma horizontale në Shqipëri

Tabela 8 paraqet në mënyrë të detajuar të dhënat e ndihmës horizontale, sipas qëllimit të përdorimit, për periudhën 2005-2007.

Tabela 9: Shpërndarja e ndihmave horizontale në Shqipëri

	Ndihma Horizontale	2005		2006		2007		TOTALI	
		në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur
	kursi mesatar i këmbimit		122,54		123,70		121,78		
1	Ndihma rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Punësimi	120,35	0,98	68,25	0,55	77,60	0,64	266,20	2,17
3	Kultura	206,50	1,69	225,00	1,82	121,07	0,99	552,57	4,50
4	Mjedisi	-		-			-	-	-
5	Eksporti	-		-			-	-	-
6	Ndihma shtetërore operacionale	76,29	0,62	71,74	0,58	67,56	0,55	215,59	1,76
7	Shpëtim dhe Ristrukturim	-		-			-	-	-
8	Kërkim dhe Zhvillim	285,89	2,33	545,09	4,41	317,60	2,61	1.148,59	9,35
9	SME-të	-		-		2,40	0,02	2,40	0,02
10	Sporti	70,10	0,57	80,00	0,65	48,61	0,40	198,71	1,62
11	Trajnimi	14,07	0,11	32,12	0,26	39,60	0,33	85,79	0,70
12	Ndihma sociale për konsumatorë individualë					2.000,00	16,42	2.000,00	16,42
	TOTALI	773,20	6,31	1.022,20	8,26	2.674,44	21,96	**4.469,84**	**36,53**

Sikurse u përmend edhe më sipër, vlera totale e ndihmës horizontale në vitin 2006 është rritur në masën 30% kundrejt vitit 2005, por në vitin 2007, nëse zbresim ndihmën për konsumatorët individualë, ajo rezulton më e ulët se secili prej viteve 2005 apo 2006.

Vetëm për vitin 2007, të dhënat e shpërndarjes së ndihmës horizontale, janë paraqitur edhe grafikisht në diagramën e mëposhtme.

Figura 3: Shpërndarja e ndihmës horizontale për vitin 2007



Nga figura 3 është e qartë se 76% e ndihmës horizontale të dhënë gjatë vitit 2007, përfaqëson

ndihmën sociale për konsumatorët individualë, e cila ka epërsi mbi të gjitha kategoritë e tjera të ndihmës horizontale. Duke qenë se kjo formë, në vetvete, është e lejueshme në bazë të nenit 7, të ligjit "Për ndihmën shtetërore"[22], si dhe për të pasur një pamje më të qartë të shpërndarjes së ndihmës për realizimin e objektivave horizontalë, analizën e mëtejshme e kemi bërë, duke mos e marrë parasysh skemën e ndihmës për subvencionimin e energjisë për konsumatorët individualë. Pra, duke zbritur nga vlera e përgjithshme ndihmën me karakter social, për periudhën 2005-2007, vlera e ndihmës së dhënë për përmbushjen e objektivave horizontalë kap shifrën prej 2,5 miliardë lekësh (20 milion €). Grafiku 4 paraqet shpërndarjen e ndihmës horizontale në Shqipëri për periudhën 2005-2007, duke përjashtuar subvencionimin e energjisë për konsumatorët individualë.

Figura 4: Shpërndarja e ndihmës horizontale për periudhën 2005-2007 në milionë lekë (përjashtuar bujqësinë, peshkimin,transportin dhe ndihmën sociale)



Punësimi	Kultura	Mjedisi	Eksporti
Ndihma shtetërore operacionale	Shpëtim dhe Ristrukturim	Kërkim dhe Zhvillim	SM E-të
Sporti	Trajnimi		

Pjesën më të madhe të ndihmës horizontale për periudhën 3-vjeçare, e zënë përjashtimet nga taksat për sektorin e hidrokarbureve (komponenti i kërkimit dhe zhvillimit), i llogaritur në 74% të totalit të ndihmës, më pas ndihma për mbështetjen e kulturës (22%), ndihma për punësim dhe trajnim (së bashku 14%) dhe, së fundi, ndihma operacionale (8.7%).

Gjatë gjithë periudhës 2005-2007, ndihma horizontale, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin, përfaqësonte 21% të ndihmës shtetërore të dhënë dhe, nëse përjashtojmë bujqësinë dhe peshkimin, 25% të totalit të ndihmës shtetërore në vend. Nëse nga këto llogaritje zbresim edhe vlerën e subvencionit për energjinë, dhënë në vitin 2007 për konsumatorët individualë, gjatë periudhës 2005-2007, ndihma horizontale përbën 12.6% të totalit të ndihmës, bashkë me sektorët e bujqësisë dhe peshkimit dhe 15%, duke përjashtuar këta sektorë.

Deri tani, në Shqipëri nuk është zbatuar ndonjë skemë e ndihmës rajonale. Nisur nga ky fakt, si dhe duke marrë parasysh masën e madhe të ndihmës shtetërore, të dhënë për përballimin e krizës energjetike në Shqipëri, në formën e ndihmës sektoriale, bëhet i kuptueshëm niveli relativisht i ulët i ndihmës shtetërore horizontale kundrejt totalit të ndihmës në Shqipëri. Megjithatë, në të ardhmen, duke iu referuar strategjisë së zhvillimit rajonal, si dhe duke patur parasysh që kriza energjetike është në rënie, ekziston mundësia që ky raport të ndryshojë,

Pjesa që zë ndihma horizontale në raport me totalin e ndihmës në vend, për vitet 2005 dhe 2006 (duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin), krahasuar me mesataren e këtyre kategorive në BE dhe në secilin prej shteteve anëtare, paraqitet në tabelën 10.

Table 10: Ndihma shtetërore horizontale në Shqipëri krahasuar me mesataren e BE-së për vitet 2005 dhe 2006[23] (përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

[22] Sipas nenit 87(2) të Traktatit të KE-së.

[23] Të dhëna nga BE dhe shtetet anëtare të BE-së:

Shtetet	2005	2006
Shqipëria	**26,6**	**30,8**
EU-25	83	85
Belgium	100	98
Czech Republic	100	100
Denmark	97	96
Germany	81	85
Estonia	100	100
Ireland	75	80
Greece	97	90
Spain	69	72
France	89	97
Italy	95	96
Cyprus	45	96
Latvia	96	100
Lithuania	84	100
Luxembourg	100	100
Hungary	48	52
Malta	3	7
Netherlands	97	97
Austria	99	51
Poland	70	85
Portugal	16	14
Slovenia	89	88
Slovakia	60	95
Finland	97	97
Sëeden	99	99
United Kingdom	90	90

Siç mund të shihet, ndihma shtetërore horizontale në BE, duke përjashtuar bujqësinë, peshikimin dhe transportin, përfaqëson më shumë se 80% të totalit të ndihmës shtetërore, ndërkohë që në Shqipëri ka qenë 27% në vitin 2005 dhe 31% në vitin 2006. Nëse bëhet krahasimi me Shqipërinë, për të dyja vitet, të gjitha shtetet anëtare të BE-së (me përjashtim të Portugalisë dhe Maltës), kanë pasur vlera më të larta të ndihmës shtetërore horizontale në raport me totalin e ndihmës së dhënë.

Duhet theksuar se, përsa i takon vitit 2007, pesha që zë ndihma shtetërore horizontale në ndihmën totale në Shqipëri (duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin) ka qenë 28%. Megjithatë, ky raport për vitin 2007 ulet në 9%, në rast se nuk merret parasysh masa e subvencionit të energjisë për konsumatorët individualë.

5.4.2. Ndihma sektoriale/vertikale në Shqipëri

Tabela 11 paraqet të dhënat e përgjithshme të ndihmës vertikale në Shqipëri, gjatë periudhës 2005 deri në 2007, duke pasur parasysh shpërndarjen sipas sektorëve të veçantë.

Tabela 11: Shpërndarja e ndihmës sektoriale në Shqipëri për vitet 2005-2007

Ndihma sektoriale (vertikale)	2005		2006		2007		TOTAL	
	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur
kursi mesatar i këmbimit		122,54		123,70		121,78		

http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/studies_reports/studies_reports.cfm.

1	Transporti publik	850,00	6,94	801,00	6,48	734,50	6,03	2.385,50	19,44
2	Shërbime publike	1.766,93	14,42	2.083,20	16,84	1.619,13	13,30	5.469,26	44,56
3	Minerat	304,29	2,48	158,00	1,28			462,29	3,76
4	Energjia	53,94	0,44	50,31	0,41	120,66	0,99	224,91	1,84
5	Audio	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Televizionet/mediat	2,86	0,02	2,86	0,02	2,86	0,02	8,58	0,07
7	Turizmi			2,00	0,016	18,90	0,16	20,90	0,17
TOTAL		2.978,02	24,30	3.097,36	25,04	2.496,05	20,50	**8.571,44**	**69,84**

Pjesa më e madhe e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë periudhës 2005-2007, është dhënë për shërbimet publike (64%). Në vlerë, kjo llogaritet në masën 5.5 miliardë lekë (ose 44.5 milionë €). Ndihma shtetërore për shërbimet publike gjatë kësaj periudhe përfshin, në veçanti, mbështetjen e qeverisë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe që është dhënë për të përballuar një pjesë të kostove operacionale[24], si dhe skemën e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për ndërmarrjet me kapital shtetëror, e cila ka mundësuar mbështetjen për ndërmarrjet me kapital shtetëror, duke iu ulur atyre detyrimin e regjistruar në bilanc. Skema e dytë është zbatuar, kryesisht, për sektorin e ujësjellsave dhe atë të minierave.

Për sa i takon sektorit të transportit, ndihma shtetërore është dhënë për mbështetjen e transportit hekurudhor. Siç mund të vihet re, ajo ka pësuar një rënie në kohë[25]. Mbështetja e shtetit për minierat ka pasur gjithashtu një rënie të dukshme gjatë vitit 2005 dhe 2006 dhe është ndërprerë në vitin 2007. Krejt ndryshe paraqitet situata në sektorin e energjisë. Edhe pse në dukje vlera e ndihmës shtetërore në sektorin e energjisë llogaritet në 2% të ndihmës sektoriale në total, siç e vumë re edhe më sipër, ndihma shtetërore në këtë sektor është rritur në mënyrë të ndjeshme, me anë të dhënies së ndihmës "Ad-hoc". Pjesa më e vogël e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, lidhet me industrinë e turizmit (0.23%) dhe sektorin e transmetimit/mediatik (0.1%)[26].

Shpërndarja e ndihmës sektoriale në Shqipëri është ilustruar në figurën 5.

Figura 5: Ndihma sektoriale (në milionë lekë) për vitet 2005, 2006 dhe 2007



[24] Rishikimi i skemës ekzistuese për subvencionimin e ujësjellës-kanalizimeve dhe Vendimi i KNSH-s kërkon një reduktim progresiv të ndihmës shtetërore dhe klasifikimi si shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik . Këto masa u pranuan nga autoritetet përgjegjëse në Shqipëri (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme) dhe po monitorohen nga DNSH.

[25] Ndihma shtetërore për transportin hekurudhor ka si qëllim kompensimin për kostot e ofrimit të shërbimit publik. Qëndrimi i KNSHsë është: rishikimi i ndihmës shtetërore për trasportin hekurudhor në Shqipëri, një kontratë publike për shërbimin publik të transportit të udhëtarëve, e cila u nënshkrua në korrik të 2007, si dhe ndarja e llogarive, kushte të vendosura nga KNSH, të cilat po ndiqen nga DNSH.

[26] Bëhet fjalë për një përfitues të vetëm të një qeraje shtetërore nën cmimet e tregut sipas një skemë, të shfuqizuar para hyrjes në fuqi të legjialcionit për ndihmën shtetërore në Shqipëri.

Edhe për kategoritë e ndihmave sektoriale, ka të ngjarë që raportet të ndryshojnë në periudhën e ardhshme. Kjo, pasi Qeveria Shqiptare po ndërmerr një sërë nismash që synojnë përmirësimin e infrastrukturës në vend dhe klimën e biznesit. Në të njëjtën kohë, mbështetja e shtetit për sektorin e transportit hekurudhor, sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe sektorin e energjisë synon të reduktohet në vite.

5.4.3. Ndihma Ad-Hoc në Shqipëri

Ndihma shtetërore Ad-hoc, në periudhën 2005–2007, ka qenë e lidhur vetëm me mbështetjen në raste emergjente. Ky ka qenë rasti i mbështetjes dhënë KESH sh.a për vitin 2007, për përballimin e çmimit të importit të detyruar të energjisë, për shkak të thatësirës që ndikoi në uljen e ndjeshme të prodhimit të energjisë në vend. Importi arriti deri në 50% të vlerës së përgjithshme të energjisë së furnizuar, ndërsa vlera e kompensimit ka qenë 5 miliardë lekë.

Tabela 12: Ndihma shtetërore Ad-hoc në Shqipëri

Ndihma Ad hoc	**2005**		**2006**		**2007**	
	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur	në mil Lek	në mil Eur
kursi mesatar i këmbimit		122,54		123,70		121,78
Mbështetje për energjinë					5.000,00	41,06
TOTALI					**5.000,00**	**41,06**

Nga të dhënat dhe analiza e bërë në këtë kapitull, dalin në pah një sërë pikash kyçe.

Së pari, totali i ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2007 llogaritet në vlerën 11.4 miliardë lekë (ose 94 milionë €), që do të thotë se gjatë këtij viti ndihma shtetërore është dyfishuar në krahasim me secilin nga vitet 2005 dhe 2006. Megjithatë, duhet thënë se ndikimi i ndihmave shtetërore në ekonomi mbetet i ulët, rreth 1.2% i GDP në 2007 (ose 0.987% kur përjashtohen ndihmat shtetërore për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit). Së dyti, ndihma shtetërore në Shqipëri është kryesisht në formën e granteve dhe masave fiskale gjatë gjithë periudhës. Së treti, ndihma shtetërore sektoriale në Shqipëri daton që para periudhës 20052007 dhe kjo të çon në një raport të ulët të vlerës së ndihmës horizontale në krahasim me ndihmën shtetërore në total gjatë periudhës 2005-2007.

Kjo mënyrë shpërndarjeje e ndihmës shtetërore në Shqipëri ndyshon nga ajo në BE. Veçanërisht pjesa që zë ndihma horizontale në Shqipëri është shumë e ulët në krahasim me mesataren e BE-së dhe shteteve të saj anëtare, me përjashtim të dy prej tyre. Ky ndryshim shpjegohet me efektin e disa faktorëve, të tillë si: detyrimet buxhetore, kriza në sektorin e energjisë, si dhe stadi fillestar i zbatimit të strategjive të zhvillimit në Shqipëri.

Megjithatë, faktorë të ndryshëm (ku përshihen, hartimi i strategjive të zhvillimit të Qeverisë Shqiptare, të cilat trajtohen në kreun 2 të këtij raporti dhe një përshpejtim i reduktimit të mbështetjes nga shteti për sektorët e transportit hekurudhor, ujësjellës-kanalizimeve dhe atë të energjisë) mund të ndryshojnë në vite strukturën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, duke e përqendruar vëmendjen në marrjen e masave të ndihmës shtetërore për përmbushjen e objektivave horizonale.

KAPITULLI 6

6. KONKLUZIONE

Raporti i parë vjetor për ndihmat shtetërore, i paraqitur nga Republika e Shqipërisë për BE-në dhe CEFTA-n, vjen si një zbatim i detyrimeve të sanksionura në MSA dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Duke qenë raporti i parë, në kapitullin 2 dhe 3 të tij paraqiten konteksti ekonomik dhe ligjor i ndihmës shtetërore dhe rregulloret përkatëse, ndërsa më pas (kapitulli 4) jepet një vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin dhe zbatimin legjislacionit të ndihmës shtetërore në Shqipëri. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2007, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2005-2007, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me vendet e BE-së (kapitulli 5).

Ky raport nënvizon faktin se ndihma totale në Shqipëri për vitin 2007 është 11.4 miliardë lekë,

shumë kjo, që është dyfishuar në raport me ndihmën e dhënë për secilin nga vitet 2005 (5 miliardë LEK) dhe 2006 (5 miliardë LEK).

Të dhënat e paraqitura në këtë raport për periudhën 2005-2007, tregojnë se ndihma shtetërore në Shqipëri shkon nga 0.61% të PPB-së në vitin 2005, në 1,2% të PPB-së për vitin 2007. Nëse do të përjashtojmë ndihmën e dhënë për bujqësinë, peshkimin dhe sektorin e transportit, ndihma shtetërore zë 0.353% të PPB-së në 2005, 0,37% në 2006 dhe 0,987% në 2007. Këto nivele të ndihmës shtetërore janë të arsyeshme për rrethanat e Shqipërisë, gjë që bëhet më e qartë nëse i krahasojmë me nivelet mesatare të ndihmës shtetërore të shteteve të BE-së, në raport me PPB-në e tyre (duke përjashtuar bujqësinë, peshkimin dhe transportin), të cilat janë 0,4% dhe 0.42%, respektivisht për vitet 2005 dhe 2006. Në fakt, ndihma shtetërore në Shqipëri, në raport me PPB-në për këto dy vite, ka qenë më e ulët se mesatarja europiane.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore për periudhën e trajtuar në këtë raport, kanë qenë subvencioni i drejtpërdrejtë, përjashtimi dhe ulja e taksave, si dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura.

Pesha e ndihmës shtetërore horizontale gjatë periudhës 3-vjecare ishte shumë e ulët: 21% ndaj totalit të ndihmës shtetërore, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin dhe 25%, duke përjashtuar bujqësinë dhe peshkimin. Nëse zbritet masa e subvencionit të energjisë elektrike për konsumatorët individualë, ky raport ulet në vlerat 12,6% dhe 15% ndaj totalit të ndihmës, respektivisht duke përfshirë, ose duke përjashtuar nga këto llogaritje ndihmën e dhënë për sektorët e bujqësisë dhe peshkimit.

Afërsisht 79% e ndihmës shtetërore është dhënë për të mbështetur sektorët e veçantë, si dhe në formën e ndihmës Ad-hoc. Pjesa më madhe e ndihmës shtetërore sektoriale në Shqipëri gjatë periudhës 2005-2007 është dhënë për shërbimet publike (64%).

Pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin "de minimis" të BE-së dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Objektivat e rinj strategjikë, që synojnë përmirësimin e infarstrukturës dhe klimës së biznesit, si dhe përmirësimin e edukimit, trajnimit, inovacionit dhe kreativitetit në biznes do të mundësojnë ndryshimin e raportit midis kategorive të ndryshme të ndihmës, duke vënë theksin në kategoritë e ndihmës horizontale. Kështu, dhënia e ndihmës shtetërore në Shqipëri, duket parë e lidhur ngushtë më një kuadër mjaft dinamik të zhvillimit ekonomik, i cili pritet të sjellë ndryshime të shpejta në këto raporte. Megjithatë, i gjithë ky proces do të paraprihet nga politika të matura dhe do të zhvillohet nën një mbikëqyrje sitematike.

VENDIM
Nr.1037, datë 2.7.2008

PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, të jetë 21 702, të ndara si më poshtë vijon:

a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë	20 602;
b) Kuota në program të dytë studimi	500;
c) Kuota për transferim studimesh	500;

ç) Kuota për shtetasit e huaj 100.

2. Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, përbëhet nga:

a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit 19 622;

b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 980.

3. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, sipas shkronjës "a" të pikës 2 të këtij vendimi, 19 620, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. 20 kuotat e tjera parashikohen për kandidatët me statusin e të verbërit.

3.1 Kuotat për kandidatët me statusin e të verbërit shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për institucionet publike të arsimit të lartë, në programe të ndryshme studimi, me propozimin e shoqatës së të verbërve. Kandidatët, që përfitojnë nga këto kuota, duhet të kenë shlyer detyrimin e maturës shtetërore dhe të plotësojnë kushtet e tjera, që përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me shoqatën e të verbërve.

4. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë, nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave bëhet nga ministritë respektive të arsimit, të cilat sjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i përcjell këto lista në institucionet publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy e shumëpalëshe.

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jenë:

a) Në Universitetin e Tiranës

- Për të gjitha programet e studimit:

i) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 15 000 lekë;

ii) Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja 15 000 lekë;

iii) Në Fakultetin e Drejtësisë 30 000 lekë;

iv) Në Fakultetin e Shkencave Sociale 30 000 lekë;

v) Në Fakultetin e Mjekësisë:

- Programet e studimit farmaci, stomatologji dhe shëndeti publik 30 000 lekë;

- Në programin e studimit mjekësi 25 000 lekë;

vi) Në Fakultetin e Infermierisë 25 000 lekë;

vii) Në Fakultetin e Histori-Filologjisë 20 000 lekë;

viii) Në Fakultetin e Ekonomisë 25 000 lekë.

b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës

i) Në programin e studimit arkitekturë 30 000 lekë;

ii) Në programin e studimit inxhinieri ndërtimi 25 000 lekë.

iii) Në programet e studimit inxhinieri elektrike dhe inxhinieri elektronike 20 000 lekë;

iv) Për të gjitha programet e tjera të studimit 15 000 lekë.

c) Në Akademinë e Arteve

i) Në programin e studimit "Regji filmi" 80 000 lekë;

ii) Për të gjitha programet e tjera të studimit 30 000 lekë.

ç) Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi"

- Për të gjitha programet e studimit 20 000 lekë.

d) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës

- Në programet e studimit:
i) Drejtim fermash dhe agrobiznes 20 000 lekë;
ii) Ekonomi dhe politikë agrare 20 000 lekë;
iii) Inxhinieri pyjesh, inxhinieri e përpunimit të drurit 20 000 lekë;
iv) Financë-kontabilitet 20 000 lekë;
v) Veterinari 20 000 lekë;
vi) Për të gjitha programet e tjera të studimit 15 000 lekë.

dh) Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
- Në programet e studimit:
i) Gjuhë-letërsi, gazetari, punë sociale dhe psikologji 15 000 lekë;
ii) për të gjitha programet e tjera të studimit 12 000 lekë.
e) Në Universitetin e Gjirokastrës "Eqrem Çabej" dhe në universitetin e Korçës "Fan S.Noli"
i) Për të gjitha programet e studimit 12 000 lekë.
ë) Në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
- Në programet e studimit:
i) Gjuhë-letërsi, punë sociale, psikologji 15 000 lekë;
ii) Drejtësi 16 000 lekë;
iii) Për të gjitha programet e tjera të studimit 12 000 lekë.
f) Në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali":
- Në programin e studimit:
i) Drejtësi 20 000 lekë;
ii) Gjuhë-letërsi 15 000 lekë;
iii) Për të gjitha programet e tjera të studimit 12 000 lekë.
g) Në Universitetin e Durrësit "Aleksandër Moisiu"
i) Për të gjitha programet e studimit 15 000 lekë.

7. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, dhe studentët e viteve më të larta, që vijnë nga shtresat sociale, si të verbër/shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës apo që vijnë nga shtresa e ish-të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa e shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me rezultate më të larta të notës mesatare të shkollës së mesme dhe të provimeve të maturës shtetërore, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Në asnjë rast, këtë përjashtim nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij vendimi, dhe kuotat e transferimeve, të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

11. Transferimet e studentëve, brenda numrit përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kritereve të përcaktuara në statutin dhe në rregulloret përkatëse.

12. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi, do ta fitojnë këtë të drejtë, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe pa iu nënshtruar detyrimeve të "Maturës Shtetërore".

13. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin një program të dytë studimi në Akademinë e Arteve, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve "Vojo Kushi", Tiranë, në programin e studimit të edukimit fizik dhe sporteve, në universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe në programin e studimit të arkitekturës, në Universitetin Politeknik të Tiranës, duhet t'u nënshtrohen kritereve të veçanta (konkurruese të pranimit), të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në ciklin e parë të studimeve.

14. Kandidatët, që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi, dhe studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet, sipas pikës 10 të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifave të shkollimit, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.13, datë 28.5.2007 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Financave.

15. Studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme, të ciklit të parë, në një program tjetër studimi, brenda të njëjtit institucion publik të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit.

16. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për caktimin e tarifave.

17. Mënyrat e plotësimit të kuotave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

18. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
1	Histori	100						90					190
2	Gjeografi	100						90					190
3	Histori-Gjeografi				90	80							170
4	Gjuhë Letërsi	100			120	80	100	120	150				670
5	Gazetari	80			80			80					240
6	Edukate Qytetare				100								100
7	Anglisht	180			100	80	100	100	160			100	820
10	Frëngjisht	100			80			80					260
11	Italisht	110			80	60		100	160				510
12	Gjuhë Spanjolle	40											40
13	Rusisht	40											40
14	Gjermanisht	100			80			80					260
15	Gjuhë Letërsi Greke	60				80							140
16	Gjuhë Turke	40											40
17	Cikli i Ulët				180	80	100	120	130			150	760
18	Cikli i Ulët Parashkollor				100	60	60	60	100				380
20	Fizkulturë							60			150		210
21	Matematikë	100						100	300				500
22	Fizikë	120						60					180
23	Inxh. Matematike dhe Informatike	90											90
24	Matematikë-Fizikë				150	80	60						290
25	Biologji - Kimi				100	80		120					300
26	Biologji	120											120
27	Kimi	80											80
28	Kimi ushqimore	80											80
29	Kimi Industriale	80											80
30	Matematikë-Informatikë					120	100						220
31	Informatikë	180						120	250				550
32	Teknologji Informacioni								250				250

33	Punë Sociale	100			100			80					280
34	Filozofi	100											50
35	Filozofi-Sociologji				90		100						190
36	Sociologji	100											100
38	Psikologji	100			90			60					250
39	Shkencat Politike	100											100
40	Drejtësi	400						200	120				720
41	Regji Filmi dhe TV									10			10
42	Aktrim									12			12
43	Regji									8			8
44	Skenografi-Kostumografi									10			10
45	Koreografi									10			10
46	Pikture									50			50
47	Skulpture									10			10
48	Muzikologji									4			4
49	Kompozim									4			4
50	Dirigjim									4			4
51	Piano									10			10
52	Violine									8			8
53	Violoncel									3			3
54	Viole									6			6
55	Kitare									6			6
56	Kontrabas									3			3
57	Flaut									5			5
58	Oboe									6			6
59	Klarinete									5			5
60	Fagot									3			3
61	Korno									2			2
62	Trombe									5			5
63	Trombone									5			5
64	Bastub									3			3
65	Kengetare									15			15
66	Shendeti Publik	80											80
67	Mjekësi	300											300

68	Stomatologji	80											80
69	Farmaci	100											100
70	Infermieri e Pergjithshme	250			150	100	120	150	250				1020
72	Mami (Infermieri)	50			100		40	90					280
73	Tek. i Larte Laboratori	35											35
74	Fizioterapi	35						30					65
76	Imazheri	35											35
77	Administrim Publik					80							80
78	Administrim-Biznes	460			100		80	120	240				1000
79	Ekonomiks	80											80
80	Ekonomia dhe e Edrejta				50								50
81	Finance-Kontabilitet	460			100	80	100	120					860
82	Info.Ekonomike	100											100
83	Administ-Biznes(Turizem)Sarande	200											200
84	Administrim-Biznes (Kukës)	100											100
85	Turizëm					90	90	120	160				460
86	Marketing						80						80
87	**PROGRAMI I STUDIMIT**	**UT**	**UPT**	**UBT**	**UE**	**UGJ**	**UK**	**USH**	**UV**	**AA**	**AEFS**	**UD**	0
89	Inxh. Navigacioni								80				80
90	Inxh. Mekanike		150						400				550
91	Inxh. Metalurgji Materiale		60										60
92	Inxh. Tekstile dhe Mode		60										60
93	Inxhinieri Elektrike		120										120
95	Inxh. Elektronike		150										150
96	Inxh. Informatike		150										150
97	Inxh. Telekomunikacioni		150										150
98	Inxh. Mekatronike		100										100
99	Inxhinieri Ndertimi		150										150
100	Inxhinier Hidroteknik		100										100
101	Arkitekturë		100										100
102	Inxh.Matematike		60										60
103	Inxh.Fizike		60										60
104	Inxhinier Gjeodet		60										60
105	Inxh. Mjedisi		60										60

106	Inxh. ne Shkencat e tokes		60										60
107	Inxh. Gjeoinformatike		100										100
108	Inxhin. i Gjeoburimeve		100										100
109	Menaxhim Agrobiznesi			150			60						210
110	Ekonomi dhe P. Agrare			150									150
111	Financë-Kontabilitet			150									150
112	Mbrojtje bimësh			100									100
113	Hortikulturë			100			60						160
114	Prodhim bimor			100									100
115	Zootekni dhe Biznes Blegtoral			100									100
116	Akuakulturë dhe Menaxh.. Peshkimi			100									100
117	Agromjedis dhe Ekologji			100									100
118	Tek. Agroushqimore			100									100
119	Vreshtari-Enologji			100									100
120	Inxhinier Pyjesh			60									60
121	Inxhinier Perpunim Druri			60									60
122	Mjekesi Veterinare			100									100
123	Inxhinieri Agronomike						60						60
124	Shkenca të Administrimit											150	150
125	Menaxhim Turizmi											150	150
128	Espert në Proceset e Formimit											100	100
129	Spec. Rrjetash Kopjuterike											200	200
130	Menaxhim Ndërtimi											60	60
131	Menaxhim Transporti											60	60
132	Teknologji Automobilash											60	60
133	Asistent Ligjor											60	60
134	Asistent Administrativ											60	60
135	Infermieri											60	60
136	Ndihmës dentist											60	60
	GJITHSEJ	**5165**	**1790**	**1470**	**2040**	**1150**	**1310**	**2350**	**2750**	**207**	**150**	**1270**	**19602**

KUOTAT PËR KANDIDATËT NGA TROJET PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

TABELA NR.2

		KOSOVA										MAQEDONI										MALI I ZI										P	R	E	S	H	E	V	E		
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	USH	UE	ASH	UD	UG.	UVI	UPT	UT	UPT	UBT	ASH	UE	UD	AA	UVI	UK		UT	UPT	UBT	USH	AS	UVI	AA		UT	UPT	UBT	AA	USH	UD	UG.	UE	UVI	AS	Σ
1	Histori	2			1							1										2			3					1				1						**11**
2	Gjeografi	2			1							1										1			3					1				1						**10**
3	Histori-Gjeografi					2			1							2																				1	1			**7**
4	Gjuhe Letersi	2			1	2			1	4		1				2			3	2		1			4		0			1				1		1	1	2		**29**
5	Edukim Qytetar																																							**0**
6	Anglisht	10			3	2		2		4		4				2	2		3	2		3			3		1			4				2	1		1	2		**51**
7	Italisht				3	1				4						2			3						5		1							2				2		**23**
8	Frëngjisht				3	1										1									5									2						**12**
9	Gjermanisht				3	1										1						2			6									2						**15**
10	Inxh. Matem. dhe Informatike	3										3										2								2										**10**
11	Cikli i Ulet				1	1		2	1	4						2	2		3	2					4		1							1	1	1		2		**28**
12	Cikli i Ulet Parashkollor				1	1			1	4						1			3	2					5		1							1		1		2		**23**
13	Fizkulturë				1		3								2										3	15								1					1	**26**
14	Matematikë	3			1							3										2			3					2				1						**15**
15	Matem-Fizikë					3			1	4						5			3	2							1									1	2	2		**24**
16	Teknologji Informacioni									10									5								2											3		**20**
17	Matem-Informatikë								1																												1				**2**
18	Fizikë	3			1							3										2			3					2				1						**15**
19	Biologji	3							1			3										2								2						1				**12**
20	Biologji-Kimi				1	3			1							5									1									1		1	2			**15**
21	Kimi	2										1										1								1										**5**
22	Kimi Ushqimore	3										3										2								2										**10**
23	Kimi Industriale	3										3										2								2										**10**
24	Informatikë	2			1							1										1			2					1				1						**9**
25	Gazetari	2			1	2						1				2						1			4					1				1			1			**16**
26	Punë Sociale	1			1	2										2						4			3					1				1			1			**16**
27	Sociologji																								1															**1**
28	Filozofi	1				2										2				2										1							1			**9**
29	Psikologji	1			1	2										2						3			3					1				1			1			**15**
30	Shkencat Pol.	1																												1										**2**
31	Drejtësi	4			1					4		3							3			3			2		10			2				1				2		**35**
32	Regjisurë																											2												**2**
33	Aktrim																											2												**2**
34	Art Skenik		5															2										2				1								**10**
35	Pikturë																											1												**1**
36	Arte Figurative		2															1										12				1								**16**
37	Muzikë		5															3										22												**30**
38	Mjekësi e Përgjithshme	3										2										3								1										**9**
39	Stomatologji	2										1										2								1										**6**
40	Farmaci	2										1										3								1										**7**
41	Shendet Publik	1										1																		1										**3**
42	Infermieri	10			1	2			1	4						2			3	2					8		1							1		1	1	2		**39**
43	Mami				1	2										2				2					3									1			1			**12**
44	Laborator	2										1										1								1										**5**
45	Fizioterapi	5			1																				5									1						**12**
46	Ekonomiks	1																							4															**5**
47	Adm-Bines(Turizem)Sarandë	1																																						**1**
48	Adminstrim-Biznesi(Kukës)	20																												7										**27**
49	Administrim-Publik								1																												1				**2**
50	Administrim.-Biznes	5			1	2				4						2			3	5		4			3		1							1			1	2		**34**

		K	o	s	o	v	a				a	M	a	q	e	d	o	n	i		M	a	l	i	Z		i	P	r	e	s	h	e	v	a		0
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	USH	UE	ASP	UD	UG.	UVI	UPT	UT	UPT	UBT	ASP	UE	UD	AA	UVI	UK	UT	UPT	UBT	USH	AS	UVI	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	UD	UG.	UE	UVI	AS	0
51	Finane-Kontabilitet	2			1	2			1			1				2				5	2			2				1				1		1	1			22
52	Inf. Ekonomike	1																																				1
53	Turizëm				3				1	4									3	5				15		1						2		1		2		37
54	Marketing																			5																		5
55	Ekonomia dhe E Drejta					1										2																						3
56	Inxh. Elektrike										2		2																									4
57	Inxh. Informatike										2		1																									3
58	Inxh. Telekomunikacioni										2		1																									3
59	Mekanikë										5		3									1							1									10
60	Inxh. Materiale										4		1																									5
61	Gjeodezi										3		1									1																5
62	Tekstil dhe Mode										5		3									1							1									10
63	Elektronik										2		1																									3
64	Ndërtim										3		2																									5
65	Arkitekturë										1		1																									2
66	Hidroteknikë										1		1																									2
67	Inxhin ambienti										3		1									1																5
68	Inxh. Matematike										3		1									1																5
69	Inxh. Fizike										3		1									1																5
70	Inxh. Mekatronike										1		1																									2
71	Inxh. Navale									4									3							1										2		10
72	Navigacion									4									3							1										2		10
73	Menaxhim Agrobiznesi			2										1						3			1							1							8
74	Ekonomi dhe P. Agrare			2										1									1							1							5
75	Financë-Kontabilitet			2										1						3			1							1							8
76	Mbrojtje Bimësh			2										1									1							1							5
77	Hortikulturë			2										1						3			1							1							8
78	Prodhim Bimor			2										1									1							1							5
79	Zootekni dhe Biz. Blektoral																																					0
80	Akuakult. dhe M. Peshkimi																																					0
81	Agromjedis dhe Ekologji			2										1									1							1							5
82	Tek. Agroushqimore			2										1									1							1							5
83	Vreshtari-Enologji																																					0
84	Inxh. Pyjesh			**2**										**1**									**1**							**1**							5
85	Inxh. Përpunim Druri			**2**										**1**									**1**							**1**							5
86	Veterinari			**5**										**3**									**1**							**1**							10
87	Shkenca të Administrimit							**2**									**2**																**1**					5
88	Menaxhim Turizmi							**2**									**2**																**1**					5
89	Ekspert ne P. Formimit							**2**									**2**																**1**					5
90	Asistent Ligjor							**2**									**2**																**1**					5
91	Asistent Administrativ							**2**									**2**																**1**					5
92	Infermieri							**2**									**2**																**1**					5
93	Ndihmës Dentist							**2**									**2**																**1**					5
94	Spec. Rrjetash Kompjuterike							**2**									**2**																**1**					5
95	Menaxhim Ndertimi							**2**									**2**																**1**					5
96	Menaxhim Transporti							**2**									**2**																**1**					5
97	Teknologji Automobilash							**2**									**2**																**1**					5
																																						0
	GJITHSEJ	**103**	**12**	**25**	**34**	**34**	**3**	**26**	**12**	**58**	**40**	**38**	**21**	**13**	**2**	**41**	**26**	**6**	**41**	**45**	**49**	**6**	**11**	**103**	**15**	**22**	**41**	**41**	**2**	**11**	**2**	**29**	**13**	**12**	**15**	**27**	**1**	**980**

KËRKESË
Nr.4766/5, datë 3.7.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme të tipit "tokë truall" që preket nga "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kv Tirana-Qendër".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT TË RI 110/20 KV TIRANA QENDËR"

RRETHI: TIRANË

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë truall

SHPRONËSIMI DEFINITIV										
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i Pasurisë	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Sipërfaqja e shpronësuar në m²	Çmimi lekë/m²	Vlera në lekë	Adresa
1.	FAMILJA		TURDIU	Truall	8370	10/175	750	42299	31724250	Tirane
Lista e Bashkëpronarëve				Truall	8370	10/175	750	42299	31724250	Tirane
1. Emine Fagu										
2. Meliha Turdiu										
3. Ramazan Turdiu										
4. Ismail Turdiu										
5. Hasan Turdiu										
6. Paqize Petrela										
7. Remzi Turdiu										
8. Haxhire Konci										
9. Hysen Belena										
10. Lejla Demneri										
11. Zyhdi Turdiu										
12. Shpresa Kazazi										
13. Ermira Kodra										
14. Parid Turdiu										
15. Silva Turdiu										
16. Arjan Turdiu										
17. Agron Turdiu										
18. Arben Turdiu										
19. Merjeme Turdiu										
20. Gazmend Turdiu										
21. Neraida Turdiu										
22. Gugash Balena										
23. Muharrem Turdiu										
24. Nermine Basha										
25. Ilir Konci										
26. Fatjona Konci										
27. Besnik Konci										
28. Fejzi Konci										
29. Zamira Konci										

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.7.2008
Doli nga shtypi më 31.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë